REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 16/01/2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 052/01 | 2575 | |


**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Opština Drenas –Municipality of Drenas



# RAPORT I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORIVE TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

Drenas, janar 2026

**Zyra e Kryetarit të Komunës**

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2025, në Zyrën e Kryetarit janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 4,331 lëndë të ndryshme, ku prej tyre 4,189 janë miratuar, 11 lëndë kanë mbetur në proces për shkak të afateve ligjore, 78 janë refuzuar dhe 29 janë anuluar. Të gjitha lëndët janë proceduar me kohë, ndërsa u është kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerrë mbi 350 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakter të përgjithshëm janë publikuar edhe në ueb-faqen e Komunës dhe të njëjtat janë dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Zyra e Kryetarit ka organizuar dy (2) takime me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar e raportuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë dhe në fund të vitit. Po ashtu është mbajtur një (1) dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasit, si dhe janë organizuar e mbajtur edhe 8 dëgjime buxhetore për buxhetin e vitit 2026 dhe projeksionin për vitet 2027-2028.

Po ashtu janë mbajtur edhe 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë mbajtur edhe 52 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor në baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet, si dhe janë diskutuar tema të ndryshme.

Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Kryetari i Komunës, gjatë kësaj periudhe raportuese ka nënshkruar 16 Memorandume të Bashkëpunimit me ministri të linjës dhe organizata ndërkombëtare për të realizuar projekte të ndryshme në të mirën e qytetarëve. Të gjitha këto memorandume janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe janë të qasshme për të gjithë të interesuarit.

Gjatë këtij viti raportues, kemi pasur shumë sfida, por edhe të arritura. Sfida kryesore kanë qenë mjetet buxhetore që janë realizuar në formën përmbarimore, gjë që ka ndikuar në realizimin e disa projekteve, ndërsa të arritura ka pasur në shumë fusha: infrastrukturë, rrjet të ujësjellësit, kanalizim, mirëmbajtje të hapësirave publike dhe përgjithësisht në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Për të arriturat e këtij viti, nuk duhen harruar falënderimet për të gjithë ata që kanë kontribuar në synimet tona të përbashkëta. Fillimisht falënderoj drejtorët e drejtorive komunale, administratën komunale, anëtarët e Kuvendit, administratorët e vendbanimeve dhe të gjithë të tjerët që kanë dhënë kontributin e tyre.

## Përmbajtja

Zyra e Kryetarit të Komunës ............ 2
Zyra për Komunikim me Publikun ............ 4
Njësia e Auditimit të Brendshëm ............ 7
Zyra ligjore ............ 9
Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore ............ 11
Zyra për Integrime Evropiane ............ 15
Zyra për Komunitete dhe Kthim ............ 18
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme............ Error! Bookmark not defined.
Drejtoria Komunale për Arsim ............ 32
Drejtoria për Infrastrukturë Lokale ............ 40
Drejtoria për Kulturë, Rinisë dhe Sport ............ 42
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ............ 50
Drejtoria e Inspeksionit ............ 54
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ............ 57
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik............ 61
Drejtoria për Buxhet dhe Financa ............ 64
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ............ 67
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ............ 68
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ............ Error! Bookmark not defined.

**Zyra për Komunikim me Publikun**

Raporti i punës Janar – Dhjetor 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Rritja e transparencës dhe mundësive të reja për komunikim | Raporti vjetor i Kryetarit për vitin 2024 | Janar-Shkurt 2025 – i përfunduar | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | Ofrimi i qasjes në Dokumente publike, | 62 kërkesa për qasje, të gjitha të qasshme për vitin 2025 | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | Raportimi tek Agjencia për Informim dhe Privatësi, | Raport vjetor Janar 2025 – raporti është dërguar në AIP | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | Raporti gjashtëmujor i Kryetarit për vitin 2025 | Korrik 2025 – është përfunduar dhe diskutuar në mbledhjen e Kuvendit | Zyra për Komunikim me Publikun |
| | | Tubimi i parë me publikun | Qershor 2025 – tubimi me publikun ka përfunduar brenda afatit ligjor dhe njoftimi është bërë 14 ditë para mbajtjes së tubimit | ZKP në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale |
| | | Treguesit e transparencës (Performanca komunale MAPL, OJQ) | Gjatë periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat që kanë qenë nga Zyra | ZKP dhe zyre komunale |
| | | Publikimi i vendimeve, procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe materialeve të Kuvendit e Komitetit | Pas kthimit të ligjshmërisë nga MAPL, të gjitha vendimet janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës | Sekretaria e Kuvendit përmes ZKP-së |
| | | Publikimi i vendimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës dhe gjitha dokumenteve të Komunës, duke përfshirë prokurimin, konkurset, njoftimet dhe dokumenteve të tjera në ueb faqen zyrtare | Të gjitha dokumentet e këtij aktiviteti, janë publikuar në ueb faqe dhe lehtë mund të vërtetohen. | Sekretaria e Kuvendit përmes ZKP-së |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Publikimi i lajmeve, shpalljeve, konkurseve dhe çdo informatë tjetër që ka të bëjë me informimin e qytetarëve në ueb - faqe dhe Facebook | Të gjitha këto të dhëna janë publikuar në ueb - faqen zyrtare dhe lehtë janë të vërtetuara | ZKP |
| | | Përcjellja e të gjitha aktiviteteve komunale | Aktivitetet e Komunës janë përcjellë e publikuar sipas afateve | ZKP |
| | | Dhënia e deklaratave për media dhe dërgimi i komunikatave të ndryshme | Për secilën media që ka kërkuar deklaratë, qoftë me shkrim apo në formë elektronike, janë dhënë | ZKP |
| | | Mirëmbajtja dhe azhurnimi i ueb faqes - zyrtare të Komunës dhe rrjetit social Facebook | Vazhdimisht është populluar me të dhënat e kërkuara ueb - faqja | ZKP |
| | | Përcjellja e mbledhjeve të Bordit, KKSB-së, KPF-së dhe Kuvendit të Komunës | Ne këto mbledhje, ka prezantuar çdo herë Zyra për Komunikim me Publikun | Komuna-KK-KPF-ZKP |
| | | Ofrimi i fotografive profesionale gjatë takimeve, eventeve, realizimit të projekteve si dhe krijimi i video - mesazheve për qytetarët | Zyra për Komunikim me Publikun ka fotografin e zyrës, i cili në mënyrë profesionale ka realizuar detyrat | ZKP |
| | | Tubimi i dytë me publikun | Dhjetor 2025 – tubimi i dytë me publikun ka përfunduar brenda afatit ligjor dhe njoftimi është bërë 14 ditë para mbajtjes së tubimit | ZKP në bashkëpunim me drejtori dhe zyre komunale |
| | | Publikimi i të gjitha dokumenteve të prokurimit në ueb - faqen zyrtare | 5 kategoritë e prokurimit, nga njoftimi për dhënie të kontratës deri të nënshkrimi, i kontratës, janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës | ZKP |
| | | Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës dhe publikim i listës së veçantë të pronave të paluajtshme që | Në muajin dhjetor, përkatësisht nga data e protokollit të dy listave dhe vendimit | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin 2025 | të Kryetarit, dokumentet janë publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës | ZKP |
| -II- | Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave publike | Konsultimi me qytetarë dhe grupe të interesit para hartimit të politikave publike | Gjatë vitit 2025 janë mbajtur 5 konsultime publike sipas Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna | Drejtoritë, ZKP |
| | | Konsultimi me qytetarë gjatë planifikimit të buxhetit, (KAB dhe buxhetin) | Në muajin korrik 2025 dhe gusht janë mbajtur, 8 dëgjime; janë mbajtur dy dëgjime buxhetore dhe janë publikuar të gjitha detajet në ueb - faqe të Komunës, nga kalendari, i dëgjimeve, thirrjet, draft-KAB-in, njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve, hartimi i procesverbaleve dhe raporti i dëgjimeve dhe publikimi i tyre | ZKP, Drejtoria për Buxhet dhe Financa |
| | | Përcjellja e objektivave që dalin nga Plani Komunal i Veprimit për Transparencë dhe Rregullorja Komunale | Janë përcjellë të gjitha aktivitetet; Plani i Veprimit që dalin nga ky dokument. Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë, komunat janë detyruar të hartojnë e miratojnë Planin e Veprimit për Transparencë si dhe Rregulloren Komunale për Transparencë dhe këto dy dokumente janë hartuar e miratuar nga Kuvendi | ZKP |

**Njësia e Auditimit të Brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2024 ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2025-2027, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2025.

Me Planin e Punës së kësaj Njësie, për vitin 2025 janë paraparë që të kryhen gjithsej shtatë auditime të rregullta. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 ka përmbushur në tërësi Planin Vjetor të punës duke kryer të gjitha auditimet e parapara me këtë Plan.

Raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në katër mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit nga ky Komitet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e Komunës.

Gjatë vitit 2025 janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar, ku nga menaxhmenti janë ndërmarrë një numër prej 44 aktiviteteve për adresimin e drejtë të këtyre rekomandimeve.

Llojet e detyrave të auditimit të realizuara gjatë vitit fiskal 2025

| Nr. | Objektivat e detyres | Aktiviteti | Fusha | Afati | Bartes i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aprovimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor. Aprovimi i Raportit të Gjashtëmujorit të dytë dhe Raportit Vjetor për vitin e kaluar. | Plani Strategjik 2025-2027, dhe Plani Vjetor 2025 | Të gjitha Drejtoratet | Janar | NJAB, KAB |
| 2 | Identifikimi dhe regjistrimi i pasurive, mirëmbajtja, menaxhimi dhe ruajtja, harmonizimi i të dhënave dhe procesi i tjetërsimit. | Auditimi: Pasuritë jofinanciare në menaxhim të Komunës. | DBF, Zyrtari i pasurive, Zyrtarët pranues | Janar – Shkurt | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 3 | Caktimi i menaxherëve të kontratave, kompetenca profesionale e tyre, hartimi i PMK, përditësimi i të dhënave, dhe përkujdesja gjatë realizimit të projekteve. | Auditimi: Menaxhimi me kontrata gjatë vitit 2024 dhe 2025 | Drejtorati i Infrastruktuës, Drejtorati i Urbanizmit DSHPE | Mars | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 4 | Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit | Viti 2024 dhe 2025 | Njësitë e audituara | Prill | NJAB, KAB. |
| 5 | Organizimi i proceseve për mbledhjen e të hyrave, | Auditimi: Inkasimi i | DPUMM dhe DBF | Prill | Njësia e Auditimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | azhuriteti, deponimi dhe transferi i të hyrave. Planifikimi vjetor i inkasimit, vendosja e kontrollave, ndarja e detyrave dhe regjistrimi i transakcioneve. | taksave nga lejet ndërtimore dhe nga qiratë | | | të Brendshëm |
| 6 | Shpërndarja e faturave, njftimi i tatimpaguesve, trajtimi i të arkëtueshmeve. Procesi i ankimimit, baza ligjore dhe organizimi i proceseve, azhuriteti në mbledhje, deponim dhe transfer të të hyrave. Planifikimi vjetor i duhur i të hyrave. | Auditimi: Të hyrat vetanake nga TPR (viti 2024 dhe 2025) | Viti 2024 dhe 2025 | Maj-Qershor | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| 7 | Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit. Shqyrtimi i raporteve gjashtëmujore për NJQHAB. Shqyrtimi i shkallës së implementimit të rekomandimeve të dhëna. | Njësitë e audituara | Gjashtëmujori i dytë | Korrik | Njësia e A. të Brendshëm, Komiteti i A. të Brendshëm |
| 8 | Sigurimi i të dhënave të qarta në lidhje me posedimin e automjeteve, përdorimi i automjeteve, kontrollet e duhura, autorizimet për lëvizje, përdorimi vetëm për nevoja të Komunës. Të dhëna të sakta mbi shpenzimet për karburante dhe shfrytëzim adekuat të automjeteve në pronësi të Komunës. | Auditimi: Menaxhimi me autoveturat e Komunes | Administrata, Shëndetësia, Zjarrëfikësit | Shtator | Njësia e Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Auditimit të Brendshëm. |
| 9 | Shqyrtimi i Raporteve të Auditimit. | Njësitë e audituara | Tremujori i tretë 2025 | Tetor | NJAB, KAB. |
| 10 | Sigurimi i respektimit të kornizës ligjore në fuqi, sigurimi i transparencës së mjaftueshme dhe kushteve të barabarta. Arritja e ekonomizimit, efikasitetit dhe Efektivitetit. Përmbajtja e planit vjetor të prokurimit. | Auditimi: Proceset e prokurimit | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | Shtator-Tetor | Njësia e Auditimit të Brendshëm |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Siguria e plotë e pagesës për kontratat e nënshkruara, limiti i kompetencave dhe administrimi i duhur i kontratave. | | | | |
| 11 | Sigurimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, organizimi i procesit të pagesave, ndarje e duhur e detyrave, planifikim i qartë dhe përmbajtje e planit të shpenzimeve, autorizim të duhur të shpenzimeve, klasifikim i duhur i shpenzimeve, shpenzim të buxhetit në proporcion me kohen, përcjellja me kohë në shuma të sakta për raportimet financiare, dhe arritja e objektivave të përgjithshme të Komunës. | Auditimi: Proceset e shpenzimit të buxhetit – pagesat gjatë vitit 2025 | Drejtoria e Financave- Procesi i shpenzimeve/pagesave. | Nëntor - Dhjetor | Njësia e Auditimit të Brendshëm |

**Zyra ligjore**

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Pranimi, shqyrtimi dhe procedimi tutje në organet administrative, gjygjësore apo edhe brenda vet institucionit të këtyre lëndëve: | - 346 Përgjigje në Padi | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |
| | | - 70 Ankesa për Gjykatën e Apelit | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | ZK |
| | | - 60 Fjalë përfundimtare | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | |
| | | - 29 Përgjigje në kërkesë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | ZK |
| | | - 33 Vendime të hartuara | Kanë përfunduar | ZK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | brenda afatit ligjor. | |
| | | - 03 Padi | Ka përfunduar brenda afati ligjor | ZK |
| | | - 1456 Propozime përmbarimore | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor. | ZK |
| | | - 11 Prapësime | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |
| | | - 04 Aneks kontrata | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |
| | | - 02 Përgjigje për masë të sigurisë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |
| | | - 07 Deklarime për seancë | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |
| -II- | Përfaqësimi i Komunës së Drenasit pranë të gjitha gjykatave në Republikën e Kosovës. | - 272 Seanca gjyqësore | Janë mbajtur në bazë të datës së planifikuar nga ana e Gjykatës. | ZK |
| | | - 50 Parashtresa të cilat përfshijnë: përmbushjen e obligimeve të gjykatave të dhëna sipas aktvendimeve në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore | Janë dorëzuar në gjykatë brenda afatit të caktuar për mbajtjen e seancës | ZK |
| -III- | Të tjera | Në kuadër të departamentit ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në Komunën e Drenasit mes tjerash janë kryer edhe hartimi i detyrimeve Kontigjente sipas kërkesës së ZKF-së, brenda afateve me ligj , realizimi i detyrave në përputhje me politikat e institucionit, dhe standardet administrative; procedurat teknike duke marr parasysh praktikat profesionale dhënia e këshillave dhe opinioneve ligjore për drejtoritë përkatëse. | Kanë përfunduar brenda afatit ligjor | ZK |

**Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore**

Raport Janar – Dhjetor 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | "Implementimi i ligjeve vendore që janë në funksion të të drejtave të njeriut, por edhe i konventave ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kushtetutën e Republikës së Kosovës." | Përpiloj raporteve narrative (tremujore, gjashtë mujore dhe vjetor të punës). | Raportet u dorëzohen ABGJ, MAPL, ZQM | Njesia për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore |
| | | Perpilimi pyetësorëve dhe raporteve të monitorimit të kërkuar nga MAPL, ZQM dhe ABGJ, në formë tabelare. | Raportet u dorëzohen ABGJ, MAPL, ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | Ndryshim-plotësimi i vendimit të Këshillit Koordinues per mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza gjinore. | Vendimi u është dorzuar ABGJ, MAPL, ZQM dhe antarëve | NJDNJZBGJ |
| | | Mbajmë takime me Këshillit Koordinues per mbrojtjen e viktimave të dhunës në baza Gjinore | Me 06. 02. 2025, Salla e Bordit | NJDNJZBGJ |
| | | Kërkesë për Planin Lokal për barazi gjinore drejtuar UN WOMEN | Me 03. 02. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Raport i funksionimit të Njësitit per vitin 2024. | Raport me 07. 02. 2025, për trajnim i dërguar në MAPL | NJDNJZBGJ |
| | | Ligjëratë për parandalimin e martesave të hershme dhe parandalimin e ngacmimit seksual në shkollat, "Shotë Galica" (Terdec) dhe në shkollen "Migjeni" (Baicë). | Raporti me 28. 02. 2025, dorëzuar në MAPL, ABGJ, ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | Punëtori për Planin Lokal të veprimit për mekanizmin e Këshillit Komunal Koordinues për mbrojtjen e viktimave të dhunes në baza gjinore. | Më 10. 03. 2025, në N'hije Zabel i Poshtem | NJDNJZBGJ dhe UN Women |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Pjesmarrja në fushatën vetëdijesuese në rrjetet sociale të projektit DEMOS për 8 Mars | Me 06. 03. 2025 | NJDNJZBGJ dhe DEMOS |
| | | Aktivitet online i zyres perms Web-faqes se komunes me rastin e 8 Marsit | Me 07. 03. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Vizita institucioneve dhe OJQ-ve me rastin e "8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas-Femrës". Vizita në QPDG, QKMF, QPS, Shtëpin Intgruese të Shendetit Mendor. | Raport, me, 07. 03. 2025 dërguar në ABGJ, MAPL, ZQM | NJDNJZBGJ |
| | | Vlerësimi Ex-post për Ligjin Nr. 06L-084 për mbrojtjen e fëmijëve | Raport me 11. 03. 2025 | NJDNJZBGJ dhe MAPL |
| | | Konsultim publik për Planin Lokal të Veprimit Zbutës për mbrotjen nga dhuna në familje ndaj grave – vajzave. | Me 04. 04. 2025, Salla e Kuvendit | NJDNJZBGJ |
| | | Aktivitet per shënimin e Ditës Ndërkombëtare të personave me Sindromën Down. | Me 21. 03. 2025, Handikos | NJDNJZBGJ dhe Handikos |
| | | Aktivitet për shënimin e 2 Prillit - Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin. | Me 03. 04. 2025 | NJDNJZBGJ dhe DKA |
| | | Miratimi i Vendimit për Planin Lokal të Veprimit per Mbrojtje nga Dhuna në baza gjinore. | Me 29. 04. 2025 | NJDNJZBGJ |
| -II- | Promovimi i të drejtave të njeriut në komunitet. | Rekomandim per organizimin e programit per 1 Qershorin, per te gjitha SHFMU-të e Komunës së Drenasit. | SHFMU Drenas | NJDNJZBGJ |
| | | Aktivitet me rastin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. | Me 30. 05. 2025 | NJDNJZBGJ dhe DKA, DKRS |
| | | 3. Takim me Ekipen për të drejtat e fëmijëve. | Me 10. 06. 2025, Salla e Bordit | NJDNJZBGJ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 4. "Njoftim për të gjitha shkolla rreth 12 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare për parandalimin e punëve të rënda dhe mbajtja e dy ligjëratave në Nekoc dhe Fushticë të Poshtme." | 12. 06. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Raportin gjashtmujor të punës për 2025, me nr. Pr. 01-052/01-26810. | 11. 07. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Procesverbali i mbledhjes së ekipit për të drejta e fëmijëve, me nr. Pr. 01-060/01-29565, (mbajtur me 11. 06. 2025). | 28. 07. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Raporti i takimit me përfaqsuesit e DEMOS-it për buxhetim gjinor, me nr. Pr. 01-060/01-29565, mbajtur me 15. 08. 2025. | 18. 08. 2025 | NJDNJZBGJ dhe Demos |
| | | 8. Rapori i takimit me e Q P D G, të mbijeturat e luftës, dhe zyrtarë institucional me nr. Pr. 01-052/01- 41924, e mbajtur me 19. 09. 2025. | 22. 09. 2025 | NJDNJZBGJ Dhe OJQ |
| | | Raporti i hapjes së fushatës "Muaji Rozë" kundër kancerit të gjirit (Tetor). me nr. Pr. 01-052/01- 43576. | 02. 10. 2025, | NJDNJZBGJ, DSHMS dhe OJQ |
| | | Kërkesën për financim të materialeve për fushatën kundër kancerit të gjirit, me nr. Pr. 01-400/01- 43630. | 03. 10. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, OJQ |
| | | Ftesë për ligjëratë për Fushatën kundër kancerit të gjirit, me nr. Pr. 01-522/01-44818, (mbajtur me 21. 10. 2025). | 13. 10. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | | Raportin e aktivitetit për Fushatën kundër kancerit të Gjirit, me nr. Pr. 01-522/01-45720, (mbajtur me 16. 10. 2025). | 17. 10. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, OJQ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Raportin e kampanjës për Fushatën kundër kancerit të gjirit, me nr. Pr. 01-522/01-45720, (mbajt me 21. 10. 2025). | 21. 10. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, OJQ |
| | | Raporti i aktiviteteve për fushatën për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, me nr. Pr. 01-052/01- 50577. Ku u realizua në 8 SHFMU me mbajtjen e Ligjeratave | 26. 11. 2025 | NJDNJ, ZBGJ, DKA dhe Policia |
| | | Kërkesën për Tryezë për parandalimin e dhunës në baza gjinore, me nr. Pr. 01-052/01- 50622. | 27. 11. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | | Kërkesën për shpenzime materialët të Fushatës për parandalimin e dhunës në baza gjinore, me nr. Pr. 01-400/01- 50623. | 27. 11. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | | Njoftimin për hapje të Fushatës 16 ditët e aktivizimit, me nr. Pr. 01-070/03- 51023. | 01. 12. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | | Ftesën për tryezë kundër dhunës në baza gjinore, me nr. Pr. 01- 060/03- 51279. | 03. 12. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | | Raportin e Fushatës kundër dhunës në baza gjinore, me nr. Pr. 01- 052/01- 51721. Ku janë mbajtur katër ligjerata në SHFMU, dhe një tryezë. | 05. 12. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | | Planin Vjetor të Punës së NKDNJ ZBGJ, për vitin 2026, me nr. Pr. 01- 052/01-52867. | 15. 12. 2025 | NJDNJZBGJ |
| III | Mbledhja e statistikave nëpër institucione | Kerkesat për statistika Të punsimit në baza gjinore përmes emailit, të githa drejtorive komunale. | 18. 12. 2025 | NJDNJZBGJ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Buxhetim gjinor | Kerkesat për shperndarje të subvencioneve në baza gjinore për buxhetim gjinor, përmes emailit, të githa drejtorive komunale. | 19. 12. 2025 | NJDNJZBGJ |
| | Dhunëa në baza gjinore | Kërkesat për statistika të dhunës në baza gjinore përmes emailit, institucionev që merren me trajtimin e dhunës . | 19. 12. 2025 | NJDNJZBGJ, DSHMS, QPS dhe Policia |
| | Regjistrim të pronës | Kërkesa në regjistrim të pronës në baza gjinore të drejtorisë së gjeodezisë. | 19. 12. 2025 | NJDNJZBGJ DKGJKP |
| | Pagesa të praktikantčav | Kërkesë Agjensisë së Punsimit të Republikës së Kosovës, për pages të Praktikantëvc. | 22. 12. 2025 | NJDNJZBGJ Zyra e Kryetarit |

**Zyra për Integrime Evropiane**

Raporti i punës Janar-Dhjetor 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Përmbushja e obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane: Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2022-2026 . Raporti i Komisionit Evropian për vendin (Kosovën) | Raporti vjetor i Kryetarit për vitin 2024, Hartimi i planit gjithëpërfshirës dhe individual për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane. Identifikimi i obligimeve të Komunës nga PKZMSA; identifikimi i obligimeve të komunave nga Raporti i vendit. Raporti për zbatimin e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane. Matrica gjithëpërfshirëse dhe individuale e raportimit në Komuna. | Janar 2024 – i përfunduar Janar- Qershor 2025 Përmbushur<br><br>Përmbushur i kryer në afatin kohor<br><br>E përmbushur | ZKIE Kryetari MAPL.<br><br>ZKIE |
| 2 | Harmonizimi i aktiviteteve me aktet ligjore të Qeverisë në koordinimin e procesit të zhvillimit të | Koordinimi i procesit të integrimit evropian. Koordinimin e aktiviteteve me Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive në | Janar-Dhjetor 2025. I vazhdueshëm. Janë përcjellë të gjitha aktivitetet | ZKIE Zyret e Kryetarit. Drejtorit. ZKP |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale, të këtij procesi, përfshirë pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale në këtë aspekt dhe koordinimin e realizimit të obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE.<br>Planin dhe programin e punës që rrjedhin nga implementimi i Planit të Veprimit i Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimit (PVMSA) , në pajtim me ligjet, Rregulloret dhe aktet tjera të organeve të pushtetit qendror dhe lokal | Komunë dhe përfaqsuesit e MAPL-së, me 22. 05. 2025 mbajtem takimin e përbashkët në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga PKZMSA-ja.<br>Koordinimin me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare të cilat ofrojnë asistencë - përkrahje në implementimin e PKZMSA -së dhe merr pjesë në këto grupe punuese.<br>Pjesëmarrja në konfernecen për"Forcimin e Rolit të komunave në promovimin e vlerave të BE"-së<br>Pjesëmarrje në konferencen e organizuar nga Qendra për Studime të Sigurisë(QKSS) mbeshteteje nga Departamenti për Punë të Jashtme i Qeveris së Irlandes, për forcimin e rolit të komunave në avancimin e vlerave të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mire si pjesë e procesit të integrimit evropian | që dalin me dokumente të reja, si udhëzimi për administrate të hapur në komuna që kan; hyr; në fuqi.<br>Është miratuar Plani i Veprimit për Transparencë si dhe rregullorja Komunale për Transparencë e që të dyja këto dokumente janë miratuar sipas procedurave ligjore. | |
| 3 | Monitorimi i zbatimit dhe raportimi për obligimet ngnda evropiane. | Raport periodik lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane<br>Janar – Qershor<br>Korrik – Dhjetor.<br>Raportimi vjetor në MAPL lidhur me përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga agjenda evropiane . | Janar-Qershor 2025<br>i përmbushur<br>Korrik-Dhjetor 2025<br>I përmbushur | ZKIE në bashkëpunim me drejtoritë dhe zyrat komunale.<br>MAPL |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në procesin e integrimit evropian. Takime lidhur me përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane. | Marrja pjesë në takimet e bordit të drejtorëve në fushën e IE. Takime të rregullta me drejtorët e drejtorive si dhe shefat e sektorëve përkatës sa i përket përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga PKZMSA-ja. Marrja pjesë në mbledhjet për planifikim buxhetor. Marrja pjesë në takime dhe trajnime në MAPL, MIE dhe Ministri e institucione të tjera që kanë të bëjnë me integrime evropiane. Marrja pjesë në Kolegjiumin e ZKIE të Asociacionit të Komunave të Kosovës me zyrtarët tjerë komunalë për integrime evropiane. | Njoftim dhe pjesëmarrje në takime në fushën e integrimeve evropiane. I vazhdueshëm. Përcjellja dhe marrja pjesë në planifikimet dhe dëgjimet buxhetore. Pjesëmarrje në takime që i ka organizuar MAPL-OSBE e ministri të tjera lidhur me procesin e IE. Pjesëmarrje në hartimin e planit të punës të kolegjiumit për integrime evropiane, si dhe sfidat që kanë dalë nga raporti i MAPL-së dhe i vendit për Kosovën. | ZKIE<br><br>ZKP, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, të gjitha drejtoritë dhe Zyret. ZKIE. MAPL |
| 5 | Adresimi i sfidave të komunave që dalin nga Raporti i Komisionit Evropian për vendin (Kosovën). Raportimi Kryetarit dhe MAPL-së nga përmbushja e obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane në baza periodike dhe sa herë që kërkohet. | Organizim dhe bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve për realizimin e obligimeve të komunave të cilat dalin nga Agjenda Evropiane dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi lidhur me këto obligime. Raportimi vjetor Kryetarit dhe në MAPL | I vazhdueshëm<br><br>5. 2.<br>I përmbushur në afatet kohore | ZKIE Drejtoritë, Kryetari, MAPL |

**Zyra për Komunitete dhe Kthim**

Raporti i punës Janar – Dhjetor 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | 1. Buxheti për vitin 2026-2028 i hartuar dhe i aprovuar (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 10.1).<br><br>2. Pjesëmarrja e rregullt në takimet që mbahen në Komunë (Rregullorja e qeverisë për ZKKK-të 02/2010, neni 7. 1. 7) | Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, ZKKK do të avokojë për buxhet të mjaftueshëm për vitin 2026. | I përfunduar | ZKKK , ZK, DBF-ZKF |
| | | Udhëheqësi i zyrës në bashkëpunim me zyrtarin për financa do të hartoj buxhetin për vitin 2026 | I përfunduar | ZKKK |
| | | Krijon kalendarin e aktiviteteve të zyrës | I përfunduar<br>Trajnim për të drejtat e komuniteteve në Kosovë mbajtur më 18, 19 Mars.<br>Takimet – si anëtare e Komisionit për vlerësimin e rreziqeve dhe planin për reagim emergjent - 3 takime | ZKKK |
| | 1. Çështjet specifike dhe nevojat e të gjitha komuniteteve, personave të riatdhesuar janë të adresuara tek | Merr planin vjetor të takimeve të KK-së dhe mban takime të rregullta me Komitetin për Komunitete si dhe takimet me KKSB | I përfunduar<br>-Kemi mbajtur 2 takime me KK , temë e diskutimeve Plani i punës së KK dhe raportim nga ZKK, 6 takime me KKSB. | ZKKK, ZK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| -II- | instiucionet lokale | Takimet me anëtaret e Kolegjiumit për Komunitete dhe Kthim, si anëtare e këtij Kolegjiumi | -Mbledhja e kolegjiumit (2 takime) kemi punuar planin e punës së Kolegjiumit. | AKK, KZKK |
| | 2. Plani i Komunal i Veprimit për Riintegrimin e personave të Riiatdhesuar 2023-2025 | Raportim i rregullt tek Kryetari, Asambleja Komunale, Komiteti për Komunitete, nese kerkohet tek institucionet qendrore, për implementimin e projekteve për personat e riatdhesuar dhe komunitetet. | Në baza të rregullta 2025 | ZKKK |
| | | Raporti gjashtë mujor | I perfunduar dorëzuar tek ZK, ZKK, MPB | ZKKK |
| | 3. Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare "GIZ", | Këshillimi i personave të riatdhesuar | Këshillimi në baza ditore, të riintegruar kemi 38 persona ( 20M, 18F) Verifikimi në teren është bërë i të gjitha rasteve së bashku me MPB. | ZKKK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | "CARITAS",<br>"INTEGRA"<br><br>4. Procesi i Migrimit pas liberalizimit të vizave | 1. Referimi i personave të riatdhesuar tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre<br>2. Komisioni Komunal për Riintegrim<br>3. Regjistrimi civil<br>4. Qasje ne punësim, Arsim Shëndetësi , mirëqenie sociale dhe digaster të tjerë<br>5. Ngritja profesionale për vetëpunësim, ngritje profesionale e personave të riatdhesuar(Trajnime duke u paisur me Diploma) dhe me mjete pune<br>6. Ndihmë personave të riatdhesuar me cenueshmëri<br>7. Pjesëmarrja e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, në takime punëtori aktivitete të tjera.<br>8. Raport mbi procesin e migrimit | Në baza të rregullta Kemi mbajtur 2 takime të KKR, kemi marr vendim për dy kërkesa: 1 vazhdim akomodimi, 2 gjera ushqimore-higjenike.<br>-Janë paisur me dokumenete të gjendjes civile<br>-Në zyën e punësimit janë paraqitur dhe kanë marrur informatat e nevojshme të gjithë personat e riatdhesuar.<br>-1familje (4 anëtarëshe) dhe një person kemi me asistencë sociale.<br>1 familje vazhdim akomodimi, gjëra ushqimore dhe higjenike, këshilla psikologjike.<br>Org. "INTEGRA", kemi fillimin e projektit për parandalimin e emigrimit të të rinjëve, "GIZ"-2 raste të referimit.<br><br>-Kemi 120 persona të larguar nga vendbanimet e tyre gjatë 2025, të dhënat nga këshillat lokale. | ZKKK, ZP, QPS<br><br>ZKKK, KKSB, KK, MAPL |

**Drejtoria për Administratë të Përgjithshme**

**I. Sektori i Gjendjes Civile**

Sektori i Gjendjes Civile ka përmbushur objektivat e planit të punës duke ofruar shërbime për qytetarët me efikasitet, profesionalizëm dhe pa pritje në sportele. Sipas statistikave të nxjerra nga sistemi i GJC-së, në afatin e paraparë ligjor, dokumente për përdorim të brendshëm janë lëshuar 29,540, ndërsa dokumente për përdorim të jashtëm janë lëshuar 19,896. Gjithashtu, kemi ofruar shërbime elektronike edhe përmes E-kioskës në Drenas dhe Komoran. Nga E-kioska në Komoran janë lëshuar 192 dokumente, ndërsa në Drenas janë lëshuar 546 dokumente.

| **Certifikata të lëshuara brenda vendit** | |
|---|---|
| Ekstrakte të lindjes | 18827 |
| Certifikata të lindjes | 1181 |
| Certifikata të marteses | 2818 |
| Certifikata të vdekjes | 1903 |
| Certifikata të vendbanimit | 312 |
| Certifikata të shtetësisë | 57 |
| Certifikata të statusit martesor | 964 |
| Certifikata të bashkësisë familjare | 3268 |
| Vërtetim nga arkiva | 210 |
| **Gjithsej** | **29540** |

| **Certifikata të lëshuara jashtë vendit** | |
|---|---|
| | |
| Ekstrakte të lindjes | 2920 |
| Certifikata të lindjes | 10262 |
| Certifikata të marteses | 3085 |
| Certifikata të vdekjes | 356 |
| Certifikata të vendbanimit | 1483 |
| Certifikata të shtetësisë | 111 |
| Certifikata të statusit martesor | 365 |
| Certifikata të bashkësisë familjare | 1064 |
| Vërtetim nga arkiva | 250 |
| **Gjithsej** | **19896** |

Janë kryer edhe punë si: regjistrime të lindjes 331, verifikime në sistem 155, rishkrimi i lindjes 132, martesa 493, rishkrim martese 263, vdekje 291, regjistrimi i qytetarit të vdekur 188, aktvendime janë nxjerrë 309, lëndë të shtetësisë 181, regjistrim i adresave 14,563, dëshmi vdekjeje për trashëgimi 365.

## I. Qendra për Shërbim të Qytetarëve

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Shërbime efikase ndaj qytetarëve (21, 153 lëndë) | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 607 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Janar 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 223 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Shkurt 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 399 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Mars 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 614 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Prill 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 433 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Maj 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 529 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Qershor 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 2, 275 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Korrik 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 2, 691 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Gusht 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 2, 682 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Shtator 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 770 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Tetor 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 151 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Nëntor 2025 | QSHQ |
| | | Janë pranuar dhe regjistruar 1, 779 lëndë të ndryshme, të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese | Dhjetor 2025 | QSHQ |
| -II- | **Rritja e shërbimeve efikase dhe** | Qendra për Shërbimin e Qytetarëve në Komunë bashkëpunon me drejtoritë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive komunale. Qendra pranon dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtoritë komunale dhe njësitë organizative brenda drejtorive. Po ashtu punë të | Janar-dhjetor 2025 | QSHQ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **punët shtesë në menaxhim** | tjera si: Bashkëngjitja dhe miratimi i lëndëve në sistemin e intranetit. Menaxhimi i kontratave në cilësinë e menaxheres (obligim me vendim nga Kryetari). Pranimi i faturave, kompletimi dhe dërgimi në procedurë të pagesës. Gjatë këtij viti është punuar edhe në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL "Stacioni i Autobusëve" Drenas, me shumë punë, përgjegjësi dhe probleme financiare të NPL-së. | | |

## II. Zyra e Prokurimit

**Zyra e Prokurimit** Gjatë vitit 2025 ka përfunduar të gjitha punët dhe detyrat sipas Planit të punës, ku me sukses ka realizuar gjithsej 110 procedura të prokurimit sipas kërkesave të Njësive Kërkuese.

| Nr. Rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Administrimi i të gjitha procedurave te prokurimit per vitin fiskal 2024 | Raporti vjetor i kontratave | Janar | Zyra e Prokurimit |
| | | Raporti gjashtemujor i Zyres se Prokurimit | Qershor | Zyra e Prokurimit |
| | | Hartim i i Planit Preliminar te Prokurimit | Nentor | Zyra e Prokurimit |
| | | Hartimi i Planit Perfundimtar te Prokurimit | Dhjetor | Zyra e Prokurimit |
| | | Hartimi i Raportit Perfundimtar | Dhjetor | Zyra e Prokurimit |
| -II- | Kontrata të nënshkruara | Kontrata te nenshkruara ne total | Gjatë vitit 2025 janë kontraktuar 78 | Zyra e Prokurimit |
| | | Pune | Gjatë vitit 2025 jane kontraktuar 20 | Zyra e Prokurimit |
| | | Sherbime | Gjatë vitit 2025 | Zyra e Prokurimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | jane kontraktuar 16 | |
| | | Furnizime | Gjatë vitit 2025<br>jane kontraktuar 24 | Zyra e Prokurimit |
| | | Aneks Kontrata | Gjatë vitit 2025<br>jane kontraktuar 6 | Zyra e Prokurimit |
| | | Vlere minimale | Gjatë vitit 2025<br>jane kontraktuar 9 | Zyra e Prokurimit |
| | | Minitender | Gjatë vitit 2025<br>jane kontraktuar 3 | Zyra e Prokurimit |
| -III- | Procedura te inicuara | Vlere e madhe | Gjatë vitit 2025<br>jane inicuar 10 | Zyra e Prokurimit |
| | | Vlere e mesme | Gjatë vitit 2025<br>janë inicuar 56 | Zyra e Prokurimit |
| | | Koentim i Çmimit | Gjatë vitit 2025<br>jane inicuar 28 | Zyra e Prokurimit |
| | | Vlere minimale | Gjatë vitit 2025<br>jane inicuar 11 | Zyra e Prokurimit |
| | | Minitender | Gjatë vitit 2025<br>jane inicuar 4 | Zyra e Prokurimit |
| | | Shitja e aseteve | Gjatë vitit 2025<br>jane inicuar 2 | Zyra e Prokurimit |

## III. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta

| Nr. rend | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartësi i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I | Funksionalizimi i Shërbimeve të përbashkëta dhe teknike në Sektorin për Mbështetje dhe Logjistikë | Raporte te procedimit të faturave për pagesa, kërkesat, faturat. Numri i faturave në procedura për pagesë është 150. Menaxhim i kontratave, mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit, komisione te vlerësimit, hartues i paramasave etj. | Janar – Dhjetor | Udhëheqsi i Sektorit |
| | | Raporte të pranimit nga Freebalanc-janë nxjerrë gjithsej 890 raporte për pagesa. | Shkurt-Dhjetor | Zyrtarja për pranim në Freebalanc |
| | | Është bërë shkarkimi i 44 zyrtareve më asete. Ngarkimi i 69 zyrtareve me asete. Janë regjistruar 117 fatura në sistemin e E-Pasurisë. Me material shpenzues janë ngarkuar 92 zyrtarë. | Shkurt-Dhjetor 2025 | Zyrtarja E-deposë |
| | | Udhëzimi i palëve te Zyra e Kryetarit dhe në të gjitha drejtoritë që kanë kërkuar shërbime; janë rreth 4,046 qytetarë | | Recepsionisti |
| | | Është bërë shpërndarja e postës për të gjitha drejtoritë/zyrat. Nr. i shkresave të dërguara është 2,017 (vendime, aktvendime, fletsa, kërkesa, ankesa etj.). | Janar – Dhjetor 2025 | Postieri |
| | | Është bërë mirëmbajtja e parkut, mbikëqyrja e punës të klimës dhe puna e nxehjes së objektit të komunës | Janar – Dhjetor 2025 | Fokisti - Mirëmbajtësi |
| | | Është bërë mbikëqyrja e furnizimit me rrymë dhe rregullimi i siguresave, dritave dhe termostateve të klimave, nxehjes në objektin e Komunës dhe gjeneratorëve | Janar – Dhjetor 2025 | Elektricisti |
| | | Rregullimi i Scan: gjithsej 55; Rregullimi i LAN: gjithsej 202; Rregullimi i Email-it zyrtar: 126; Rregullimi i PC-së: 130; Instalimi i printerëve: 124; Rregullimi i programit për foto: 18. Lëshimi i mikrofonave dhe inçizimit për mbledhjen e Kuvendit Komunal: 13; Lëshimi i mikrofonave dhe inçizimi për KKSB-në: | Janar-Dhjetor 2025 | Zyrtarja e IT-së |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 12; Ruajtja e skedarëve (files) të mbledhjes: 16.<br><br>Furnizim më karburant i automjeteve 246 herë.<br>Furnizimi më karburant në liter sasia 11380. 99 litër.<br>Furnizimi më benzinë 19. 05 litër<br>Furnizim karburant naftë për gjenerator 126. 01 litër. | Janar-Dhjetor 2025<br><br>Janar – Dhjetor 2025 | Zyrtari përgjegjës automjete |
| II | Raporti periodik dhe vjetor, vlerësimi i zyrtarëve dhe plani i trajnimeve për punëtorë | Raporte javore, tremujore, gjashtëmujore dhe raporti vjetor. Mbikëqyrja e punës së zyrtarëve të Sektorit. Vlerësimi i zyrtarëve për punën njëvjeçare. Hartimi i planit për trajnimin e zyrtarëve dhe pushimeve vjetore | Janar – Dhjetor<br><br>Shkurt-Mars | Udhëheqsi i Sektorit dhe Udhëheqsi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore |

## IV. Sektori i Arkivit

| Nr. | Departamenti | Numri i lëndëve |
|---|---|---|
| 1. | Zyra e Kryetarit të Komunës | 821 |
| 2. | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Zyra e Kuvendit | 691 |
| 3. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 0 |
| 4. | Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 0 |
| 5. | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 1199 |
| 6. | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 253 |
| 7. | Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë | 0 |
| 8. | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | 0 |
| 9. | Drejtoria për Arsim | 0 |
| 10. | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 0 |

| | | |
|---|---|---|
| 11. | Drejtoria e Inspekcionit | 91 |
| 12. | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë | 0 |
| 13. | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale | 1 |

**Gjithsej 3,056 lëndë të arkivuara në mënyrë fizike.**

Numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë fizike për të gjitha programet për vitin 2025 është 3,056; krahasuar me vitin 2024, kemi 2,437 lëndë më pak. Ndërsa, numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet nga gjashtëmujori i parë i vitit 2025 është 9,948. Kjo shifër është raportuar duke marrë parasysh faktin se programi SMAED ka qenë dhe është aktualisht jashtë funksionit. Sektori i Arkivit kryen edhe punë të tjera në shërbim për qytetarët si vijon:

1. **Deklaratë për ushqim** për vitin kalendarik (mbajtës i familjes), për bashkatdhetarë për të gjitha shtetet – 523 lëndë.
2. **Certifikatë për shtesa të fëmijëve**, për punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja – 10 lëndë.
3. **Vërtetim mbi jetën** për të gjithë bashkatdhetarët – 134 lëndë.
4. **Deklaratë e udhëtimit** për shtetas të huaj – 6 lëndë.
5. **Legalizim i të gjitha dokumenteve** nga origjinali – 24 lëndë.

Për këto shërbime, në vitin 2025 kemi proceduar gjithsej **697 lëndë**.

## V. Zyra për Teknologji Informative

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -I- | Administron , menaxhon dhe mirëmban sistemin e TI-ve dhe proceseve të qeverisjes elektronike në administratën e komunës. | 1. Administrimi i rrjetit në objekt të Komunës | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 2. Administrimi rrjetit në disa institucione të tjera shtetërore komunale | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 3. Administrimi pajisjet e IT-së në Komunë | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 4. Ndihmon dhe mbështet të gjithë stafin në përdorimin e pajisjeve të IT-së | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 5. Mban kontakte të rregullta me ASHI-në ne implementimin e proceseve të e-Qeverisjes në MAP | Janar-Dhjetor | ZTI |
| -II- | Planifikon, dizajnon , integron , siguron | 1. Krijon llogaritë në Intranet për shfrytëzuest | Janar-Dhjetor | ZTI |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | (bazën e te dhënave ), barte , freskon , administron dhe mbështet sistemet dhe kërkesat ne fushën e IT-së | 2. Siguron bazën e të dhënave të Intranetit | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 3. Ep jep privilegjet për shfrytëzuesit | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 4. Mirëmban Active directory | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 5. Ruan të dhënat në DT në ASH | Janar-Dhjetor | ZTI |
| -III- | Udhëheq dhe koordinon procesin e freskimit dhe përpunimit të mëtutjeshëm të strategjisë në nivel komunal me investimet në e-Qeverisje, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve komunale. Menaxhon dhe udhëheq pajisjet e telefonisë. | 1. Komunikon me posten elektronike me këshilltarët | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 2. Administron dhe konfiguron tel VoIP | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 3. Krijon llogarit për këshilltarët , mirëmban dhe ndihmon këshilltarët | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 4. Instalon sistemet operative sipas UA | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 5. Mbikëqyr sistemin e sigurisë. | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 6. Është pjesë e grupeve punuese në nivel vendi për të gjitha aplikacionet digjitale lokale dhe migrimin e shërbimeve komunale në platformën e-Kosova. | Janar-Dhjetor | ZTI |
| -IV- | Ndihmon në implementimin e proceseve të e-shërbimeve dhe aplikacioneve në Komunë si: (Intraneti, ueb faqja, e-Pasuria, GJC, Arka, etj.) dhe zhvillon shërbimet e e-qeverisjes në institucionet komunale, si dhe trajnon dhe mbështet stafin në përdorimin e aplikacioneve | 1. Ndihmon shfrytëzuesit në aplikacionin e GJC-së | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 2. Administron aplikacionin e intranetit | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 3. Ndihmon shfrytëzuesit në aplikacionin e TP-së | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 4. Ndihmon shfrytëzuesit në të gjitha aplikacionet në Komunë | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 5. Administron me ueb faqe dhe krijon meny dhe faqe sipas kërkesave. | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 6. Ndihmon në të gjitha aplikacioneve tjera ne komunë | Janar-Dhjetor | ZTI |
| -V- | Siguron dhe mbron të gjitha të dhënat që ruhen në serverët e Komunës, administron llogaritë zyrtare, domenin dhe krijon të reja | 1. Administron me AD, krijon llogarit, hapjen e e-mailave zyrtar për të gjitha kërkesat qe vine nga ZBNJ | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 2. Administron me dhomën e serverëve dhe sigurinë e tyre | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 3. Ka ruajtur shënimet nga Outlook | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 4. Është përkujdesur për vazhdimin e qasjes dhe resetim te pasvordëve. | Janar-Dhjetor | ZTI |
| | | 5. Administron duke krijuar qasje të punëtorëve në sistemet: SIMBNJ, SVMP, SMAED e aplikacione të | Janar-Dhjetor | ZTI |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | tjera; janë kryer kërkesat online për ID dhe shërbime të tjera. | | |

## VII. Sektori për Punë të Kuvendit Komunal

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje.

| Emri i K. | Mbledhje të rregullta | Mbl. Të jashtëzakonshme | Mbl. urgjente | Mbl. solemne | Mbledhje inauguruese |
|---|---|---|---|---|---|
| Komuna Gllogoc (Drenas) | Gjatë periudhës Janar-dhjetor 2025 . Kuvendi Komunal ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta. Janar, 31. 01. 2025 https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/01/Ftesa-e-mbledhjes-se-rregullt-te-KK-te-dt. -31. 01. 2025. pdf | Gjatë periudhës Janar-dhjetor 2025 . Kuvendi Komunal ka mbajtur 2 mbledhje të jashtëzakonshme | Nuk ka pas mbledhje të urgjente | Gjatë periudhës janar-dhjetor Kuvendit Komunal ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje solemne | Gjatë periudhës janar–dhjetor, Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsej 1 mbledhje inauguruese. Mbledhja inauguruese: 10/12/2025 |
| | Shkurt, 28. 02. 2025 https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-dhe- | | | 14. 02. 2025 https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-per- | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Materiali-i-KK-per-mbledhjen-e-28. 02. 2025. pdf | | | mbledhjen-solemne. pdf | |
| | Mars, 28. 03. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/03/Ftesa-dhe-materjali-i-mbledhjes-se-KK-e-dt-28. 03. 2025. pdf | | | 05. 03. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/03/ftesa-e-mbledhjes-solemne-05. 03. 2025. pdf | |
| | Prill. 29. 04. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/04/Ftese-dhe-procesverbali-i-mbledhjes-se-Kuvendit-te-Komunes. pdf | | | | |
| | Maj. 29. 05. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/05/Ftesa-dhe-materiali-i-mbledhjes-se-rregullt-te-dt. -29. 05. 2025. pdf | | | | |
| | Qershor. 30. 06. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/20 | | | 13. 06. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/06/Ftesa-per- | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 25/06/Ftesa-dhe-materiali-i-mbledhjes-se-Kuvendit-Komunal-dt. -30. 06. 2025. pdf | | | mbledhje-solemne. pdf | |
| | Korrik. 21. 07. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/07/ftesa-dhe-materjali-i-mbledhjes-se-KK-se-te-dt. 30. 07. 2025. pdf | | | | |
| | Gusht - pushim | | | | |
| | Shtator. 25. 09. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/09/Ftesa-dhe-Materiali-per-mbledhjen-e-rregullt-te-Kuvendit-Komunal. pdf | | | | |
| | Tetor-Nëntor – Fushata zgjedhore | | | | |
| | Dhjetor 2025 | Mbledhje e jashtëzakonshme 17. 12. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/2025/12/Ftesa-per-mbledhjen-e- | | | Mbledhja Inauguruese 10. 12. 2025<br><br>https://gllogoc. rks-gov. net/wp-content/uploads/20 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | jashtezakonshme.pdf<br><br>Mbledhje e jashtëzakonshme 24. 12. 2025<br><br>https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Ftesa-me-permiresime.pdf | | | 25/11/Ftese-e-mbledhjes.pdf |

Gjatë periudhës janar–dhjetor, janë miratuar nga Kuvendi Komunal i Drenasit gjithsej 43 vendime. Prej tyre, 4 janë kthyer nga MAPL-ja pasi nuk kanë qenë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi; prej të cilave 3 janë shfuqizuar, një është rishqyrtuar, ndërsa në pajtim me legjislacionion në fuqi mbeten 39 vendime.

**Drejtoria Komunale për Arsim**

Raporti i punës për vitin 2025

| Numri rendor | Objektivat | Aktiviteti | Afati | Bartesi I Aktivitetit | Aktivitetet e realizuara |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Objektivi i Përgjithshëm DKA-së për vitin 2025 | DKA-ja do të fokusohet në gjithëpërfshirje që çdo nxënësi pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet për nxënie cilësore. | 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Vizioni zhvillimor i përshpejtuar i arsimit parauniversitar. Adaptimi i hapësirave në shkolla për shërbime në EFH | 2025 | DKA - Shkollat - Komunitet | Në proces |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ngritja e kapaciteteve të DKA-së në funksion të përmbushjes së rolit të tyre mbikëqyrës<br><br>Zhvillimi dhe fuqizimi i mekanizmave për komunikim dhe koordinim efektiv midis palëve të interesit të niveleve të ndryshme në sistem përmes raportimit dhe proceseve koordinuese | 2025 | DKA | Realizuar |
| | | Shkollat të jenë një ambienti i sigurt dhe një mjedis motivues për nxënësit dhe mësimdhënësit | 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Rritja e kapaciteteve dhe funksionalizimi i shërbimeve pedagogjike-psikologjike në institucione edukativo-arsimore në të gjitha nivelet | 2025 | DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve<br><br>. | 2025 | MASHTI-DKA-Shkollat-Projekti i BE-së dhe Projekti "Avancimi I përshpejtuar I cilësisë në Arsim, strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të arsimit në Komunën e Drenasit" | Realizuar |
| | | Mbështetje pedagogjike për nxënësit që nuk kanë arritur rezultatet në fushën e gjuhës, shkencës dhe matematikës | 2025 | MASHTI-DKA-Shkollat-Projekti I BE-së dhe Projekti ''Avancimi I | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përshpejtuar I cilësisë në Arsim, strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të arsimit në Komunën e Drenasit" | |
| | | Digjitalizimi i Institucioneve Arsimore | 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Mbështetje e vazhdueshme për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave për zbatimin e kurrikulës (me theks të veçantë në aspektet e mësimdhënies së avancuar dhe në fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat dhe çështjet ndërkurrikulare dhe lëndore) | 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Bashkëpunimi i ngushtë me Inspektoratin e Arsimit dhe akterë tjerë me qëllim të ngritjes së cilësisë | 2025 | DKA - Inspektorati i Arsimit- Shkollat | Realizuar |
| | | Ngritja e vazhdueshme profesionale e mësimdhënësve përmes shumë projekteve si nga MASHT, Bashkimi Evropian, Gizi, Caritasi-Zvicerran për nivelin parafillor dhe fillor dhe shumë projektet tjetra me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim. | 2025 | DKA - Partneret/donator et- Shkollat- OJQ | Realizuar |
| | | Mbikëqyrjen dhe menaxhimin e projektit Hartimi dhe Implementimi i projektit " avancimi i përshpejtuar i cilësisë në arsim – strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të arsimit në komunën e Drenasit . | 2025 | DKA - QAPA- Shkollat | Realizuar |
| | | Pilotimin e projektit të vetëvlerësimit të shkollës duke i përfshirë 5 fushat e | 2025 | DKA - zyra e BEse- Shkollat | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | cilësisë, projekt ky i zyrës së Bashkimit Evropian me 5 shkolla pilot në Komunën e Drenasit | | | |
| | | Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore në nivel të DKA-ve për mbështetjen e shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës zyrtarë/këshilltarë pedagogjik në lëndët prioritare - Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat, sipas numrit të nxënësve | 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Monitorimi dhe raportimi i rregullt i Institucioneve arsimore në DKA, duke u bazuar zbatueshmërin legjislacionit në fuqi dhe implementimin e strategjisë | | DKA - Shkollat | Realizuar |
| 2 | Ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve për mësimdhënie cilësore | Organizimi i trajnimeve në nivel të Komunës dhe me bazë në shkollë | 2025 | MASHTI-DKA-Shkolla-OJQ | Realizuar |
| | | Vlerësimi i dosjeve për kurrikula-KKK-KB | 2025 | DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Fuqizimi i Aktiveve Profesionale në shkolla | 2025 | DKA Shkollat | Realizuar |
| 3 | Objektivi në nivelin parashkollor dhe parafillor | Analizë e planit dhe programit të punës për vitin 2025 | 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| | | Analizë e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar sipas legjislacionit në fuqi | 2025 | DKA-QEAP-Shkollat | Realizuar |
| | | Identifikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, raportimi i | 2025 | DKA-QEAP-Shkollat | Realizuar |
| 4 | Nivelet e arsimit parauniversitar (0 – Parashkollor, 1- Fillor, 2 – | Përgatitja për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2024 -2025 | Janar 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Përpunimi statistikor i suksesit të nxënësve për vitin shkollor | Janar 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Arsim i mesëm i ulët , 3 –Arsim i mesëm i lartë) | 2024/2025 në gjysëmvjetorin e parë | | | |
| | | Vizita pune në shkolla me karakter të përgjithshëm, informativ, mbikëqyrës dhe special (niveli 1, 2, 3) | Janar - Dhjetor/ 2025 | DKA - | Realizuar |
| | | Planifikimi dhe monitorimi i regjistrimit të nxënësve në kl. I-parë 2025/2026 | Qershor - Korrik Gusht 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Planifikimi i profileve, orëve mësimore dhe kuadrit arsimor për vitin shkollor 2024/2025 me theks të veçante për shkollën profesionale IAAP " Fehmi Lladrovci " | Maj- Qershor 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| | | Evidentimi i nxënësve të kl. IX-ta për Testin e arritshmërisë dhe caktimi i qendrave të testimit. | Prill /2025 | MASHTI- DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasë të X-ta | Qershor- Korrik Gusht/ 2025 | MASHTI- DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Përpunimi i të dhënave për konkursin e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të (shpallja e konkursit nga MASHT, DKA) | Qersh or- Korrik Gusht/ 2025 | MASHTI- DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Mbajtja e Testit të Arritshmërisë. | | MASHTI- DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Publikimi i rezultateve, shqyrtimi i ankesave dhe analiza e testit të Maturës dhe Arritshmërisë nga DKA | | MASHTI- DKA Shkollat | Realizuar |
| | | Mbajtja e Testit të Maturës. | Qershor- Gusht 2025 | MASHTI- DKA- Shkollat | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Organizimi të manifestimeve të ndryshme me rastin e festave. | Janar – Dhjetor 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Përgatitja për shënimin e Ditës së Mësuesit (7 Marsit), në të gjitha shkollat me programe kulturore dhe aktivitete të ndryshme | Shkurt - Mars 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Përgatitjet për shënimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës — 17 Shkurt 2024 | Shkurt 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Përgatitjet për shënimin e Epopesë së lavdishme të UÇK-së (5, 6, 7 Mars). | Mars-2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Organizimi i ditës së shkollave | Janar – Dhjetor 2025 | DKA - Shkollat | Realizuar |
| | | Organizimi i Olimpiadës së Matematikës 2025 në nivel Komunal. | Mars-Prill 2025 | DKA - Shkollat, Shoqata e MA | Realizuar |
| | | Konkursi për kuadrin arsimor sipas kërkesave të shkollave dhe pranimi i tyre . | Janar – Dhjetor 2025 | DKA | Realizuar |
| 5 | Shërbimet profesionale psikologjike-pedagogjike | Vlerësimi sistematik i nxënësve me nevoja të veçanta nga Ekipi për Vlerësimin Pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta (Zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës, psikologu, punëtori social dhe mësimdhënësi mbështetës). | Janar - Dhjetor 2025 | DKA Shkollat - Ekipa nivel komunë | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Mbështetje e fëmijëve me status të ulët socio-ekonomik në arsimin e obligueshëm | Janar - Dhjetor 2025 | AP- DKA - Shkollat - Ekipa komunale | Realizuar |
| 6 | Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës | Orientimi në karrierë Organizimi i ngjarjeve "Ditët e dyerve të hapura". | Janar Dhjetor 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| | | Ndërtimi i lidhjeve me komunitetin e biznesit për kryerjen e praktikës profesionale | Janar- Dhjetor 2025 | DKA-Shkolla Profesionale- Bizneset | Realizuar |
| | | Mbajtja e praktikës profesionale për secilin profil. | Janar Dhjetor 2025 | DKA-Shkolla Profesionale- Bizneset | Realizuar |
| | | Planifikimi i profileve bazuar në nevojat e tregut | Janar Dhjetor 2025 | DKA-Shkolla Profesionale | Realizuar |
| 7 | Menaxhimi lidhur më çështjet ligjore dhe të personelit | Menaxhimin i çështjeve ligjore dhe të personelit lidhur me stafin e tre sektorëve të Arsimit në Komunën e Drenasit për drejtor, zv drejtor, sekretar, bibliotekistë, pedagog, mësimdhënës dhe stafin tekniko shërbyes. | Janar – Dhjetor 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| | | Menaxhimin e kontratave dhe i evidentimin e gabimeve në kontratat e mësimdhënësve dhe stafit tjetër në institucionet arsimore. | Janar – Dhjetor 2025 | DKA- Zyra e Personelit- Shkollat | Realizuar |
| | | Përgjigjët e kërkesave dhe ankesave të stafit të institucioneve arsimore për çështjet ligjore që lidhen më kërkesat dhe ankesat e tyre. | Janar – Dhjetor 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| 8 | Menaxhimi Financiar | Dërgimi i kërkesave në zyrën e prokurimit për zhvillimin e procedurave të prokurimit për DKA & shkolla, si dhe kërkesa shtesë sipas nevojave të shkollave. | Shkurte- Nentor 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |
| | | Hartimi i Planit Cash për Buxhetin 2025;Plani i | 2025 | DKA- Shkollat | Realizuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | zotimeve dhe Plani i shpenzimeve. | | | |
| | | Analiza e realizimit të buxhetit për çdo muaj për (paga, mallra & Shërbime, komunali, kapitale, subvencione). | 2025 | DKA-Shkollat | Realizuar |
| | | Përgatitja e projekteve sipas prioriteteve nga mjetet kapitale. | Janar – Mars 2025 | DKA-Shkollat | Realizuar |
| | | Monitorimi i vazhdueshem i disciplinës financiare në institucionet arsimore. | Janar - dhjetor 2025 | DKA-Shkollat | Realizuar |
| | | Analiza e shpenzimeve buxhetore për vitin 2025. | TM1, TM2, TM3 dhe TM4 | DKA-Shkollat | Realizuar |
| 9 | Projektet Kapitale | Furnizimi i shkollave me paisje të TIK-ut. | 100, 000. 00 | DKA-Prokurimi-Shkollat | Realizuar Përmbarim |
| | | Instalimi nxemjeve qendrore - riparimi kulmit në SHFMU"Xheladin Gashi-Plaku",Komoran. | 80, 000. 00 | DKA-Prokurimi-Shkollat | Realizuar Përmbarim |
| | | Krijimi kabineteve dhe klasve për mesim me një ndërrim SHFMU "Halil Bajraktari", Drenas "Fazli Grajqevci", Sankoc, "Jusuf Gervalla" Negroc, "Shote Galica Abri", Fehmi &Islam Kastrati Nekove, Abedin Bujupi Arllat | 128, 018. 00 | DKA-Prokurimi-Shkollat | Realizuar Përmbarim |
| | | Ndertimi i aneksit të shkollës "Arif Shala" dhe "Naim Frashëri". | 160, 000. 00 | DKA-Prokurimi-Shkollat | Realizuar |

**Raporti i punës Janar – Dhjetor 2025**

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| I. | **Informimi i palëve** | • Puna me palë të ndryshme<br>• Pranimi i lëndëve (kërkesave) të ndryshme nga palët 671<br>-Të aprovuara 622 | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Të refuzura 37<br>• Pelqime infrastrukturore 25 | Janar - Dhjetor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |

**Drejtoria për Infrastrukturë Lokale**

Raport pune për 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| I. | **Informimi i palëve** | • Puna me palë të ndryshme<br>• Pranimi i lëndëve (kërkesave) të ndryshme nga palët 671<br>-Të aprovuara, 622<br>- Të refuzura, 37<br>• Pelqime infrastrukturore 25 | Janar - Dhjetor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |
| -II- | **Zhvillimi i infrastrukturës Lokale** | Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshec L= 3, 000m'<br>Rregullimi trotuareve dhe ndriqimit publik Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobroshec dhe Baic , L=90, 000m' ndriqim publik,<br>**Projekte në proces**<br>-Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xhevë Lladrovci" Drenas,<br>-Ndërtimi, zgjërimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfalltuar në Drenas në gjatësi L= 1000m' shtresa e parë e asfaltit (Rruga "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci"),<br>-Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas; kyqje shtëpiake 1.500, ndërsa janë realizuar 46, 657. 00 m' gyp të ujësjellësit,<br>-Ndërtimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklist në parkun e Kamenicës Drenas ne gjatësi L=280m',<br>-Ndërtimi i shtijeve për biqikleta dhe promovim i transportit publik, | Janar - Dhjetor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Asfalltimi I rrugvë dhe kubzim në Drenas I, II, III dhe IV; rrugë me asfalt 630m', rrugë me kubza 350m' , faza e parë L=802m' zhavorr,<br>-Asfalltimi I rrugëve në Komoran I, II, III dhe IV rrugë asfalt L=100m' dhe faza e parë e punimeve L=200m'(zhavor),<br>-Asfalltimi i rrugëve në fshatin Terstenik I, II dhe Gllobar, Faza e parë e punimeve L=3267m' (zhavor),<br>-Asfalltimi i rrugëve në fshatin Sankoc, Fushtice e Epërme dhe e Ulet, Faza e parë e punimeve L=700m' (zhavor),<br>-Asfalltimi i rrugëve në fshatin Shtutic Verboc dhe Polluzhe , Faza e parë e punimeve L= 1400m' (zhavor)<br>-Asfalltimi i rrugëve në fshatin Nekoc, Kizharekë me gjatësi L= 1085m',<br>-Ndertimi dhe zgjerimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve,<br>-Ndërtimi i rrugëve fushore në Komunën e Drenasit, faza e parë e punimeve L= 4000m' zhavor, ndërtimi i rrugës Gllanasell- Gllobar gjatësi L=1, 450m'( zhavorr),<br>-Ndertimi, zgjerimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve ne Drenas L= 9270m',<br>-Ndërtimi i rrugës Ilaz Kodra në Verboc L= 2450m' asfalt, faza e dytë e punimeve investim nga MMPHI<br>-Ndërtimi i rrugës Sankoc-Harilaq ( dalja ne magjistralen M9) me gjartësi L= 2958m' asfalt, faza e dytë e punimeve e punimeve investim nga MMPHI,<br>-Asfaltimi i rrugës Llapushnik- Berishë, faza e dytë e punimeve në gjatësi L=4, 240m' asfalt, nga Grandi i Përformancës,<br>-Ndërtimi i rrugës Berishë deri në Kompleksin Memorial – Tek bunkeri i Radios Kosova e lirë Drenas, faza e parë e punimeve në gjatësi L=1, 640m' (zhavorr), investim nga MMPHI. | | |
| -III- | **Menaxhimi i projekteve** | Në të cilin janë përfshirë zyrtaret e drejtorisë së infrastrukturës i cili si proces ka planifikim, organizimin, drejtimin si dhe kontrollin,<br>Ky proces është i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës së | Janar - Dhjetor | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | qytetarëve përmes zhvillimi të qëndrueshëm të infrastrukturës. | | |

**Permbledhje e Realizimeve:**

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale ka realizuar

- **Asfaltim:** L= 30, 026m',
- **Zhavorr fazë e parë e punimeve:** L= 12, 2463m',
- **Ndriçim Publik:** L=90, 000m',
- **Kolektor të ujërave zeza:** L=300m',
- **Kanalizim i ujërave te zeza:** L= 9270m',
- **Trotuar:** L= 2, 280m',
- **Shtigje për çiklist:** L=280m',
- **Ura dhe tombina:** - 2 copa,
- **Ujësjellës dhe kyçje individuale:** L= 46, 657m' ujësjellës dhe 1, 500 kyçje individuale.

**Drejtoria për Kulturë, Rinisë dhe Sport**

| **Aktivitetet kryesore në DKRS për Janar- Dhjetor, 2025** | **Arritjet/progresi/përformanca kyçe e vitit 2025** |
|---|---|
| **Aktivitetet kulturore** | **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës në periudhën janar-qershor dhe ka kryer këto aktivitete:**<br>– Plani dhe programi i punës i DKRS-së për vitin – 2026,<br>– Përgatitja e raportit vjetor të DKRS për vitin - 2025,<br>– Kërkesa fillestare buxhetore,<br>**Aktivitete në Sektorin e Kulturës:** |

-Takime individuale më punëtorët e DKRS-së,
Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2025,
Përgatitje e kërkesave fillestare për Buxhet të DKRS-së, **2025, 2026, 2027,**
-17 Shkurti - Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Komunën e Drenasit, u mbajt Sofrës Poetike "Ymer Elshani" 2025, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarit "Agim Deva",
-DKRS në bashkëpunim me DKA-në kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershorin, kemi realizuar aktivitetin me fëmijët e Çerdhes "Ardhmëria",
-Realizimi i Orës Letrare me shkollat e Drenasit në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve , , Agim Deva'',
-Me rastin e shënimit të 14 Qershorit Ditës së Çlirimit, 26 Vjetorit të qytetit tonë u dekorua me flamuj dhe Bilborda, u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe te Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve në Komunën tonë,
-Shënimi i muajt të Mërgatës;
-Aktiviteti i realizuar Kongrsi i Manastirit-1908;
-Shënimi i festave të Nëntorit në sallën e Kulturës, mbajtja e ekspozitës etj,
-Festivali i fëmijëve të këngëve dhe valleve "Talentët e Rinj",

-Pjesmarrje e 2 antarëve të DKRS-së në trajnimet e organizuara nga UNDP me programin "ReLOaD3" në 5 Module.

**Zyrtarja Administrative e DKRS-së**

-Përgaditja e planit të punës për vitin 2026

-Mbajtja e protokollit intern për sektorët e DKRS-së ;

-Pranimi i faturave dhe kërkesave të ndryshme përmes protokollit në DKRS;

-Përgatitja e kërkesave të DKRS-së dhe dërgimin e tyre për procedurat e pagesës; procedimin e lëndëve për pagesë në Drejtoratin e Financave;.

-Punë së bashku me stafin e DKRS-së në organizimin e Aktiviteteve -- Kulturore, Sportive, Rinore;

-Punë në Komisione të Vlerësimeve të Projekteve nga Prokurimi;

-Punë në Menaxhimin e Kontratave "Buqeta me lule për homazhe" dhe si dhe "Furnizimi me invertar",

Punë në Komisione të caktuara nga Zyra e Kryetarit për pranimin e mallrave dhe punë të ndryshme sipas kërkesave të DKRS-së;

Pjesmarrje në trajnimet e organizuara nga UNDP me programin "ReLOaD3" 5 Module;

Trajnim dy ditor në IKAP " Menaxhimi i kontratave"

Përpunimin e Lëndëve të DKRS-së në Sistemin e Intranetit 420 gjatë kësaj periudhe 01/01/2025 – 19/12/2025

**Operatori Teknik**

-Sherbim me mjete të zërimit në aktivitete komunale dhe DKRS-së, akademi përkujtimore, aktivitete kulturore, shërbim me zërim në ditët e shkollave të Komunës së Drenasit etj,

-Riparimin e mjeteve të zërimit të cilat kanë qenë të dëmtuara;

-Shërbim me mjetet e zërimit për aktivitetin e orës letrare, Festës së Abetares,

-Angazhim në përgatitjen e sallës dhe përcjellja në aktivitetet e "17 Shkurtit" Ditës së Shpalljes së Pavarsisë së Kosovës;

-Angazhim në përgatitjen e sallës dhe përcjellja në aktivitetet e 14 Qershorit Ditës së Çlirimit të Drenasit,

-Angazhimin me mjete të zërimit në zbulimin e Përmendores së Heroit të Kombit Asllan Fazliut,

-Shërbim më mjete e zërimit për mbatjen e Kongresit të Manastirit,

-Angazhim në përgatitjen e sallës dhe përcjellja e aktivitetit me mjetet e zërimit për festat e Nëntorit në Sallën e Kulturës;

-Agazhim në përgatitjen e sallës dhe përcjellja e aktivitetit me mjetet e zërimit për Festivali i Këngëve dhe Valleve "Talentët e Rinj" ,

-Angazhimi në mbajtjen e aktiviteteve të organizuara nga klubet sportive në Palestrën "Hysni Jetullahu".

**Arkivi Historik i Komunës**

Në raportin vjetor janë kryer këto punë:

-77 lëndë të pranuara përmes Intranetit janë përpunuar dhe janë bashkangjitur lëndët përcjellse;

| | |
|---|---|
| | -77 kërkesa janë pranuar nga palët;<br>-4 çertifikata shkollore janë lëshuar për palë;<br>-73 njoftime janë përgatitur për palë;<br>-20 ditarë me regjistra të nxënësve të klasëve të teta janë evidentuar në kompjuter;<br>-10 kuti me lëndë arkivore të përpunuar ne fondet arkivore;<br>-Skanimin e lëndëve të Fondit nr. 9, Fondit nr. 23 Raporte të punës së shkollave për periudhën e v. 1957 – 82;<br>-Janë përpunuar, rregulluar, skanuar lëndët e Këshillit komunal Financiar për Arsimin Shqip: Raporte statistikore, plane analiza etj. , vitet 1992-1997;<br>-Sipas vendimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike nga DKRS për vitin 2025;<br>Përgatitjen e materialeve (Broshurave, Banerave) për pjesmarrjen e Komunës së Drenasit në Panairin e Turizmit në Prishtinë me të gjitha komunat e Kosovës;<br>-Përgatitjen e të dhënave në fushat e Trashëgimisë Kulturore për plotësimin e Draft dokumentit të pranuar nga Kordinatori i grupit për plotësim të Draftit: "Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Drenasit",<br>-Plotësimin e sherbimeve nga Arkivi dhe sherbimeve nga DKRS për vitin 2024-2025 për lehtësimin e barrës Administrative;<br>Së bashku me stafin e DKRS-së kemi marr pjesë në mbajtjen e aktiviteteve Kulturore, Sportive e Rinore;<br>-Plotësimin e të dhënave së bashku me drejtoreshën e Administratës, Formularin për aplikim për shprehjen e interesit për pjesmarrje në Programin Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Përendimor **(ReLOaD3)**<br>Punë tjera shtesë jashtë Arkivit:<br>-Përgatitjen e materialeve në një raport të përgjithshëm për aktivitetet e realizuara për vitin 2024, ngritjen e këtij raporti në sistemin SEMPK të Përformancë të ngritura në Maj të vitit 2025; |

-Përgatitjen e Formularit të Raporti për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane Janar-Qershor 2025,

-Përgatitjen e materialeve me të dhënat për përkrahjen e OJQ-ve dhe ndërtimin e infrastrukturës tereneve sportive për DKRS-në për Institutin GAP;

-Gjatë këtij viti kam pranuar **10 vendime** nga zyra e Prokurimit për vlersimin e Ofertave për projektet e shpallur,

-Përgatitjen e materialeve (Mirënjohjeve) në Librarinë Likoshani për Dëshmorët e komunës së Drenasit me rastin e "14 Qershorit Ditës së Çlirimit të Drenasit";

-Sipas vendimit jam i caktuar si anëtar i komisionit për vlerimin e 5 kërkesave për ndarjen e subvencioneve jashtë thirrjes publike nga DKRS për vitin 2025;

-Sipas vendimit jam caktuar anëtar rezervë të ekipit komunal për zbatimin e Projektit ReLOaD3.

***Vërejtje: Punës si Zyrtar i Lartë për Administrim dhe Digjitalizim të Materialit Arkivor kam filluar me datën 06. 10. 2025. Deri me këtë datë punët. Në Sektorin e Arkivës i ka kry zyrtari Kajtaz Kastrati.***

**B i b l o t e k a t**

Gjatë këtij viti kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona me libra të rinj, të cilët janë dhuruar donacion nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës.

| Biblioteka | Dhuruesi | Titulli i veprës | Tituj të rinj | Exemplarë të rinj | 2025 |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Drenas | BKK-Pjetër Bogdani | / | 12 | 133 | 2025 |
| | Tërstenik | BKK-Pjetër Bogdani | / | 12 | 133 | 2025 |
| | Komaran | BKK-Pjetër Bogdani | / | 12 | 133 | 2025 |
| | Arllat | BKK-Pjetër Bogdani | / | 12 | 133 | 2025 |
| | Gjithsej | | | 48 | 532 | 2025 |

**Bibliotekat; Drenas, Komaran, Tërstenik, Arllat**

**Për muajt; Janar-Dhjetor, 2025**

| Viti **2025** | Nr. i ekzemplarëve | Nr i titujve | Ekzemplarë të rinj | Tituj të rinj | Libra të lexuara | Nr. i lexuesve | Lexues të rinj | Gjithsej lexues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drenas | 11339 | 4495 | 424 | 34 | 165 | 117 | 40 | 117 |
| Tërstenik | 6523 | 1874 | 236 | 29 | 371 | 298 | 56 | 371 |
| Komaran | 7002 | 3668 | 133 | 12 | 290 | 254 | 27 | 254 |
| Arllat | 5931 | 1266 | 763 | 305 | 869 | 866 | 1 | 867 |
| **Gjithsej** | **30, 795** | **11, 303** | **1, 556** | **380** | **1, 695** | **1, 535** | **124** | **1, 609** |

**Sektori i Rinisë**

- Takime me KVRL-në rreth zhvillimit dhe projekteve të reja për Rininë e Drenasit,
- Përgatitjen e raportit (listës) të subvencioneve për Zyrën e Kryetarit dhe një kopje për drejtorinë e DKRS-së;
- Së bashku me stafin e DKRS-së jam angazhuar në detyrat e caktuara nga DKRS në aktivitetet Kulturore, Sportive dhe Rinore;
- Më datë 06.01.2025 kam pranuar vendimin nga Kryetari i Komunës si u.d. Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe kam përfunduar më 01.07.2025;
- Gjithashtu kam kryer edhe detyrat e zyrtarit të rinisë;
- Vendim për formimin e grupit punues për bashkëpunim me organizatën Helvetas, projekti DEMOS, për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore komunale për vitin 2026.
- Takimi përfundimtar për zhvillimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik se si janë përfunduar;
- Trajnim: "Fuqizimi i të rinjve: Kuptimi i kornizës së re ligjore";

- Gjithashtu kam dërguar kërkesën në KEDS, për ta vendosur njehsorin e dy stadiumeve, në stadiumin e qytetit si dhe stadiumin në Zabel të Ulët, si dhe në stadiumin e qytetit "Rexhep Rexhepi";
- Kam pranuar fatura të kompanisë së transportit "Joni Travel", si dhe kam bërë raportet e faturave.
- Kemi dalë në terren bashkë me Drejtoreshën e DKRS-së në Bibliotekat në Arllat, Komoran, si dhe në objektet sportive;
- Takim në "Emerald": "Themelimi i Këshillave Rinore Lokale – Hapat e ardhshëm dhe përgjegjësitë e komunave";
- Dita e Rinisë më 14 Shtator: KVRL ka organizuar një vizitë te Kalaja e Vuçakut bashkë me KVRL-në, ku prezent isha edhe vetë në këtë vizitë;

Trajnim 3-ditor me organizatën e UNDP për rini: Integrimi i agjendave "Rinia, Paqe dhe Siguria" (YPS) dhe "Gratë, Paqe dhe Siguria" (WPS) në nivel lokal;

Pranimin e vendimit për emërimin e Komisionit për vlerësimin e pasurive jofinanciare në sektorin e Administratës së Përgjithshme.

## Sektori i Sportit

- Është hartuar Plani i Punës për vitin 2026.
- Kam marrë pjesë në komisione të ndryshme në bazë të vendimit të kryetarit të komunës.
- DKRS në bashkëpunim me DKA-në, ka zhvilluar garat në sporte të ndryshme në bashkëpunim me SHFMU-të dhe SHML-të, sipas Kalendarit të garave të Federatës së Sportit Shkollor gjatë vitit 2025.
- Janë ndihmuar OJQ-të dhe klubet sportive me transportin e lojtarëve për zhvillimin e lojërave kampionale, pjesëmarrje në evente të organizuara nga federatat e ndryshme.
- Në palestrën sportive "Hysni Jetullahu" është mbajtur turniri memorial "Rexhep Rexhepi".
- Në palestrën sportive "Hysni Jetullahu" është mbajtur turniri me mësimdhënësit e Edukimit Fizik dhe të Sportit në futsall për nder të festës së Pavarësisë së Kosovës më 17.02.2025.
- Me përkrahjen e DKRS-së janë mbajtur turniret për nder të dëshmorëve: "Tre heronjtë e fshatit Nekovc", "Dëshmorët e Korroticës së Epërme", "Mehdi dhe Sylejman Bytyqi".
- Më datë 01.11.2025 është mbajtur turniri në boks "Drenasi 2025".
- Zyrtari i sportit i është përgjigjur kërkesave të ndryshme nga klubet sportive në bazë të ligjit për sport, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi.
- Zyrtari i sportit ka ndihmuar dhe prezantuar në mbledhjet e mbajtura nga klubet sportive në seanca stërvitore dhe ndeshje kampionale të zhvilluara gjatë këtij viti.
- Zyrtari i sportit me zyrtarët e objekteve sportive dhe fushave sportive ka bërë kërkesa për mirëmbajtje dhe rregullimin e tyre.
- Zyrtari i sportit gjatë këtij viti i ka përcjellë klubet sportive të komunës sonë që janë të regjistruara në Regjistrin e DKRS-së si klube publike në shumë seanca stërvitore dhe ndeshje kampionale ku janë zhvilluar aktivitete sportive në Drenas dhe jashtë komunës.
- Janë zhvilluar takime me OJQ-të dhe klubet sportive për plotësimin e dokumentacionit-formularëve për subvencionimin e tyre.
- Sektori i sportit në bashkëpunim me KOK dhe DKA e Drenasit ka zhvilluar aktivitetin sportiv me fëmijët e lindur në vitin 2008 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpike.

- Sektori i Sportit (DKRS) e ka mbajtur aktivitetin e Zgjedhjes së më të mirëve në lëmin e sportit të klubeve dhe individëve që kanë pasur rezultate gjatë vitit 2025.

***1. Sportisti i Vitit 2025***

1. " Shpresim Zogu "Fc Feronikeli 74"

**Ndër Dhjetë Sportistët/Sportistet e Vitit 2025**

2. Diellza Krasniqi – Futbolliste e Klubit "Feronikeli Femrat"
3. Fjolla Shala - Klubi Boksi "Drenasi",
4. Diart Gorani - Klubi i Volejbollit "Feronikeli" (F),
5. Suela Gashi – Klubi Volejbollit "Gryka",
6. Leotrim Elshani – Klubi i Volejbollit "Feronikeli" (M),
7. Lea Selmani –Klubi i Notit Ilirida,
8. Eduarta Berisha Klubi i Volejbollit "Gryka",
9. Ervin Shabani – Klubi i Boksit "Drenasi",
10. Oltion Gashi– Klubi Futbollistik "Feronikeli 74".

***2. Trajneri/ja e vitit***

*1. Elmi Zymeri - Klubi i Volejbollit Feronikeli*

***3. Klubi i vitit***

*11. FC Feronikeli 74*

***4. Sportisti/ja më me përspektivë***

*1. Orges Gjoka - Shkolla e Futbollit Feronikeli 74*

*1. Loresa Zogaj - Klubi i Volejbollit Feronikeli*

***5. Gjyqtari/ja e Vitit***

*1. Granit Qorri*

***6. Punëtori/ja Sportiv i vitit***

*1. Besnik Nebihi - Klubi Volejbollit Gryka*

***8. Sponzori- Donatori i Klubit***

*1. Aktiv Home - Klubi Feronikeli 74*

*2. Gjeocenter Sh. P. K - Klubi Volejbollit Gryka*

*3. Abria Travel 2000 Sh. P. K- Klubi I Volejbollit Gryka*

***9. Nxënësi / nxënësja më e mirë në sport***

*1. Erza Gashi*

***10. Mësimdhënësi/ja e Edukatës Fizike***

*1. Fidan Ramadani*

Me mirënjohje të veçantë nga Kryetari z. Ramiz Lladrovci janë nderuar edhe:

- Fitim Krasniqi, Klubi i Futsallit "Prishtina 01",
- Shqiprim Imeri, Klubi i Futsallit "Drenica",
- Asdren Krasniqi, Kikboks.

**Përmbledhja e aktiviteteve në objektet sportive Janar- Dhjetor 2025**

| Muaj: Janar Dhjetor, 2025 | Stervitje | Orë | Numri lojtarëve | Shikues | Lojë kampionale |
|---|---|---|---|---|---|
| Stadiumi Sintetik | 1, 035 | 1, 829 | 29, 774 | 5, 280 | 164 |
| Palestra Sportive | 346 | 849 | 6, 244 | 10, 144 | 78 |
| Stadimu Rexhep Rexhepi | 154 | 347 | 5, 240 | 9, 547 | 24 |
| Gjithësej | 1, 535 | 3, 025 | 41, 258 | 24, 941 | 266 |

Objektivë e DKRS-së mbetet realizimi i planit në përpikëri për vitin-2026.

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Raporti i punës Janar - Dhjetor 2025

| Nr. | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | | 1. Puna me palë.<br>2. Pranimi i lëndëve të ndryshme nga palët. | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| I. | Informimi i palëve | 3. Njoftime të ndryshme për palët të cilët i janë drejtuar drejtorisë për legalizim, leje ndërtimi, Leje Mjedisore Komunale dhe çështje që kanë të bëjnë me lëndët, plotësim të lëndëve me dokumentacionin e nevojshëm, raporte profesionale nga ekspertët përkatës etj. | 2025 | DUMM |
| -II- | Rritja e transparencës dhe mundësive të reja për komunikim | 1. Raporti vjetor i punës për vitin 2025 nga DUMM,<br>2. Kompletimi i dokumentacionit dhe ofrimi i qasjes në dokumente publike,<br>3. Raportimi tek ASK për TM1, TM2, TM3, TM4 për Leje Ndërtimi,<br>4. Raporti i gjashtëmujorit të parë dhe të dytë për punët e kryera në drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për vitin 2025,<br>5. Performanca komunale-Treguesit MAPL(plotësimi të dhënave të kërkuara). | Gjatë periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat nga DUMM dhe nga drejtoritë tjera | DUMM, dhe zyrtarët nga drejtoritë tjera |
| -III- | Trajtimi i objekteve të ndërtuara pa leje -Legalizimi | 1. Kontrollimi i lëndëve me dokumentacionin e bashkëngjitur , konsultime me palë në lidhje me kërkesat e tyre, gjeodetë që kanë bërë inqizimin e objekteve dhe ixhinierët në lidhje me raportet profesionale që kërkohen për legalizimin e objekteve,<br>2. Hartimi 95 Vendimeve për përfshirje në listën e pritjes për objekte të ndërtuara pa leje,<br>3. Hartimi i 42 Vendimeve-Çertifikatë të legalizimit për objekte të ndërtuara pa leje të kategorisë së I-rë dhe II-të të ndërtimeve. | 2025 | DUMM |
| -IV- | Planifikim i qëndrueshëm-Leje Ndërtimi dhe Çertifikata Përdorimi | Shqyrtimi i lëndëve për Leje Ndërtimi dhe Çertifikata të Përdorimit,<br>9. Numri i përgjithshëm i kërkesave për leje ndërtimi është 118,<br>10. Hartimi i 54 Vendimeve për Leje Ndërtimi,<br>11. Hartimi i 58 Vendimeve për refuzim të Lejes Ndërtimore,<br>12. Në proces janë 6 lëndë,<br>13. Hartimi i 10 Vendimeve për Çertifikata të Përdorimit, | 2025 | DUMM |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 14. Hartimi i 25 vendimeve për ndrrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,<br>15. Përgatitja e faturave për pagesën e taksave për Leje Ndërtimi, për taksën e densitetit, për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje, për ndrrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. | | |
| -V- | Mbrojtja e Mjedisit-Leje Mjedisore Komunale dhe Gjelbërimi i hapsirave Publike | 1. Pranimi dhe Shqyrtimi i lëndëve për Leje Mjedisore Komunale-LMK,<br>2. Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2029,<br>3. Hartimi i Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit 2025-2029,<br>4. Kontrolli dhe raportim tremujor i ndotjes së ujërave sipërfaqësore,<br>5. Hartimi i 27 Mendimeve Profesionale për LMK,<br>6. Hartimi i 27 Vendimeve për Leje Mjedisore Komunale-LMK<br>7. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për projektin me titull: Gjelbërimi i Hapsirave Publike mbjellja e drunjve dekorativ shumëvjeçar në Drenas,<br>8. Menaxhimi i kontratës dhe realizimi i punimeve në terren për rregullimin e hapsirave me gjelbërim. | 2025 | DUMM |
| -VI- | Emërtimi i rrugëve – Vendosja e sistemit të adresave, vendosja e tabelave dhe numrave të hyrjeve të objekteve | 1. Është bërë databaza e sistemit të adresave dhe numrave në sistemin ARIS,<br>2. Janë vendosur tabelat për emërtimin e rrugëve në teren dhe numrave të hyrjeve për objekte të ndryshme afariste, banimore, bujqësore, sportive, shëndetësore, administrative dhe institucione tjera ,<br>Sa i përket sistemit kontrollit të të dhënave për projektin e emërtimeve të rrugëve dhe futjen në sistemin ARIS janë realizuar këto punë:<br>3. Vendosjen e 19 Shtyllave,<br>4. Vendosjen e 28 Tabelave për emërtim rrugësh,<br>5. Vendosjen e 410 numrave të shtëpive para hyrjes së objekteve. | 2025 | DUMM |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| -VII- | Planifikimi i buxhetit | 1. Përgatitja e kërkesave fillestare për planifikimin e buxhetit (KAB) | 2025 | DUMM |
| -VIII- | Puna në Komisione dhe menaxhime të kontratave | 1. Hartimi i Raportit për Listën e Rreziqeve të Komunës (koordinator),<br>2. Hartimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Drenasit ( koordinator),<br>3. Përditësimi i Planit të Integritetit të Komunës së Drenasit ( koordinator),<br>4. Shërbime profesionale dhe administrative në Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale ( menaxhim i kontratës),<br>5. Gjelbërimi i hapsirave publike (menaxhim i kontratës),<br>6. Verifikimi i titullit juridik të dokumentave 5 aktvendime,<br>7. Komisionin për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të inspektoratit të ndërtimit,<br>8. Komisionin për zvoglimin e Barrës Administrative,<br>9. Vlerësimi i ofertave të ndryshme në zyrën e Prokurimit,<br>10. Puna në Komisionin -Inventarizimi i pasurive jofinanciare (anëtar)<br>11. Puna në Komisionin Komunal për Riintegrimin e personave të riatdhesuar,<br>12. Puna në Komision në projektin "Banimi Social Adekuat",<br>13. Pranime teknike të projekteve të ndryshme kapitale.<br>14. Rekomandime për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale më pak se një vit,<br>15. Aktvendime për vendosjen e paneleve solare në objekte ekzistuese me leje ndërtimi. | 2025 | DUMM |

Sa i përket planifikimit të të hyrave në DUMM, realizimi i të hyrave gjatë vitit 2025 është në vlerën prej 538,185.55 € apo 180.7 % mbi vlerën e planifikuar.

**Drejtoria e Inspeksionit**

| | |
|---|---|
| Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën Janar – Dhjetor 2025 për realizimin e prioriteteve | Drejtoria e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën Janar - Dhjetor 2025 i ka kryer duke u bazuar në planin e punës. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe është bërë edhe punë shtesë dhe jashtë orarit të punës, ndërsa kompensimi është bërë me ditë të lira dhe me pagesë.<br><br>Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025 inspektorët kanë sjellë raportet ditore të punës, ndërsa nga Shefi i Inspeksionit janë hartuar raportet javore për punët e kryera në këtë Drejtori. Në vazhdimësi janë përcjellë dhe paguar të gjitha obligimet (faturat) për mallra dhe shërbime.<br><br>Është bërë edhe zbatimi i planit të zotimeve dhe shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime për periodat e vitit 2025.<br><br>Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 janë kryer punët dhe detyrat e punës nën mbikëqyrjen inspektuese si vijon:<br><br>**-Inspektimet** lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj.<br><br>**-Inspektimet e ndërtimit** në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, përcjellja sipas fazave të ndërtimit si dhe inspektimet finale. Ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.<br><br>**-Inspektimi** rreth ndotësve të ambientit, inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale.<br><br>**-Inspektimi** i taksive ilegale, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet, respektimi i shenjave të komunikacionit, etj.<br><br>**-Inspektimi** i mënyrës së shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore etj.<br><br>**-Inspektime** lidhur me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, rrugëve, pastrimin e tyre nga akulli dhe bora, trotuaret, sheshet. Inspektime lidhur me pajisjen me pëlqim për rrjetin e ujësjellësit, vendosjen e reklamave dhe panove të ndryshme, shfrytëzimin e hapësirave publike, etj.<br><br>-Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në terren. |

| | |
|---|---|
| Inspektori i tregut | Nga lëmia e tregut për periudhën janar-dhjetor 2025 është bërë inspektimi mbi paisjen me certifikata të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut, respektimin e orarit të punës, deklaracioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi.<br>Konform Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e Tregut nr. 03/L-181 janë inspektuar subjektet afariste (mallrat bazike elementare ushqimore vaj, miell etj. ), rreth përmbushjes së standardeve të mallrave për vendosjen e tyre në treg, çmimeve, dekleracionit të mallit, afatit etj.<br>Po ashtu janë inspektuar furrat e bukës , kontrollimi i përdorimit të njësive matëse dhe peshoreve në qarkullim.<br>Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve.<br>Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.<br>Lëshuarja e aktvendimeve (pelqimeve) për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve afariste.<br><br>**Janë bërë 307 inspektime, 193 procesverbale, 15 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë, 6 aktvendime për mbyllje dhe janë shqiptuar 49 gjoba mandatore në shumën prej 9 900. 00 €.** |
| Inspektori i Ndërtimit | Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, inspektimet sipas fazave të ndërtimit si dhe inspektimet finale, mure, objekte pa leje etj.<br>Aty ku janë hasur ndërtime pa leje nga inspektorët e ndërtimit është urdhëruar ndërprerja e punimeve ndërsa për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhërat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese si dhe janë zhvilluar procedurat e nevojshme që nga procesverbalet, aktvendimet për nderprerje të punimeve, gjobat mandatore, nxjerrja e draft-urdhërave për ekzekutim e deri te kallximet penale.<br>Gjatë kësaj periudhe janë bërë: Inspektimi i lejeve të ndërtimit, Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). Inspektimi i fazave të ndërtimit dhe inspektimet finale.<br>Aktvendimet për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale dhe urdhërat për rrënimin e ndërtimeve pa leje.<br>Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen, instalimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore.<br><br>**Gjatë kësaj periudhe janë bërë 262 inspektime, 176 procesverbale, 70 aktvendime për pezullim të punimeve pa leje, 69 urdhëra për ekzekutim ( në procedurë për konfirmim), si dhe 59 gjoba në shumë prej 82, 000 €.** |
| Inspektori i Mjedisit | Në lëmin e mjedisit gjatë kësaj periudhë Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma, inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave, etj.<br>Gjatë kësaj përiudhe është bërë:<br>Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, parqeve dhe vendeve tjera publike.<br>Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në deponinë adekuate,<br>Inspektim dhe identifikim i deponive ilegale në tërë territorin e komunës së Drenasit,<br>Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj,<br>Inspektim i varrezave të makinave mbeturinave të tjera të ngjajshme, |

| | |
|---|---|
| | Inspektimi i Gurthyesve, dhe fabrikave të tjera që shkaktojnë ndotje në mjedis sipas kërkesave.<br><br>**Gjithsej janë bërë 66 inspektime, 40 procesverbale si dhe janë shqiptuar 3 gjoba mandatore në vlerë prej 750. 00 €.** |
| Inspektori i Komunikacionit | Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për transportin rrugor dhe rregullorës për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem i vazhdueshëm është edhe më tutje operimi i kombi-taksive (8+1), Janë inspektuar Operatorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit<br>Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:<br>Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaksit),<br>Inspektimi i pajisjes së transportueseve me leje operimi, orar të udhëtimit,<br>Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë, parkingje etj,<br>Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësiti në Drenas janë zhvilluar aksione për largimin e taksive ilegal (8+1) nga komunikacioni.<br><br>**Për këtë janë bërë 21 inspektime, 10 procesverbale.** |
| Inspektori i Bujqësisë | Inspektori i Bujqësisë ka bërë mbikqyrje inspektuese rreth ruajtjes së tokave bujqësore dhe të komosacionit e sidomos rreth shfrytëzimit të tyre për bujqësi. Në kuadër të kësaj është përcjellë që tokës bujqësore të mos i ndërrohet destinimi pa pëlqim e që mos të fillojnë gërmime apo rrafshime të terenit për qëllime tjera në toka bujqësore,<br>Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:<br>Inspektimi i mënyrës se shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes, nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore,<br>Inspektimet e barnatoreve bujqësore dhe kontrollimi i imputeve bujqësore (farërat, plehrat artificiale),<br>Punët dhe detyrat tjera sipas urdhrit të Shefit apo Drejtorit,<br><br>**Gjithsej janë bërë 63 inspektime, 54 procesverbale, 9 Urdhër rrënime, 6 gjoba mandatore në vlerë prej 2 600. 00 €.** |
| Inspektori i Shërbimeve Publike | Inspektori i Shërbimeve Publikeka bërë mbikëqyrjen e shfrytëzimit të pronës publike nga palë të treta, mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, rrugëve, pastrimin e tyre nga akulli dhe bora, trotuareve, shesheve. Inspektime lidhur me vendosjen e reklamave dhe panove të ndryshme, etj,<br>Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:<br>Inspektim i largimi të borës para lokaleve afariste,<br>Inspektim i mirëmbajtjes dhe pastërtisë së parqeve,<br>Inspektimi i reklamave dhe panove të ndryshme,<br>Inspektime të rrugëve dhe trotuareve,<br>Inspektim i terasave që shfrytëzojn hapësirat publike,<br>Inspektime të ndryshme me kërkesa të palëve.<br>**Gjatë kësaj periudhe janë bërë 137 inspektime, 95 procesverbale dhe janë shqiptuar 14 gjoba mandatore në shumë prej 6 800. 00 €.** |

Pasqyra e punës në shifra për periudhën janar-dhjetor 2025

| Lëmia Inspektuese | Inspektime | Procesverbale | Aktvendime | Gjoba mandatore | Vlera e gjobave në Euro | Draft-urdh. Ekzek. | Rrënime | Mbyllje të lokalev | Konfiskim i targave dhe automjeteve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Treg | 307 | 193 | 21 | 49 | 9 900. 00 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ndërtim | 262 | 176 | 70 | 59 | 82 000. 00 | 69 | 0 | 0 | 0 |
| Mjedis | 66 | 40 | 0 | 3 | 750. 00 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Komunikacion | 21 | 10 | 0 | 0 | 0. 00 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bujqësi | 63 | 54 | 9 | 9 | 2 600. 00 | 9 | 0 | 0 | 0 |
| Shërbime Publike | 137 | 95 | 0 | 14 | 6 800. 00 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 856 | 568 | 100 | 134 | 102 050. 00 | 78 | 0 | 0 | 0 |

**Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

Raporti vjetor për vitin 2025

| Nr. | Objektivat | Aktivitetet | Afati | Bartës te aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Përgaditja e raportit gjashtë mujor dhe vjetor të punës së DBZHR-2025 | 1. 2. Mbledhja e të dhënave,<br>1. 3. Përgaditja e të dhënave lidhur me raportin,<br>1. 4. Përpunimi final i raportit | Qershor-<br>Dhjetor | Udheheqësi<br>Drejtori |
| 2. | Bashkëpunim me OJQ-të rreth përkrahjes së projekteve(IADK),<br>Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc,<br>Projekt me GIZ-in gjerman | 2. 1. Është bërë thirrja publike për projekte, dhënja e këshillave për plotësim të aplikacioneve dhe pranimi i dokumentacionit,<br>2. 2. Dalja në terën të fermerët aplikues për përzgjedhjen e përfituesve,<br>2. 3. Në projektet nga IADK kanë përfituar 6 fermer (3 fermër në sektorin e Blegtorisë me paisje të ndryshme laktofriza, bidona për qumësht, digjitalizim në shtallë si dhe | Janar<br>Dhjetor | Stafi<br>Udheheqësi<br>Drejtori |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3 fermër ne sektorin e perimkulturës me rrjetë për hijezim të serrave),<br>2. 4 Ështe bërë thirrja publike për fermerët që posedojnë sipërfaqe të tokës bujqësore ne sistemin e ujitjës,<br>2. 5. Në sistemin e ujitjës se Ibër Lepencit janë përfshir 119 fermër ku janë ujitur mbi 250 ha,<br>2. 6. Ështe bërë thirrja publike për projektin, skema e granteve mbeshtetur nga Qeveria Gjermane përmes GIZ Kosova në bashkëpunim me MBPZHR, realizuar në bashkëpunim me D&D Business Support Center,<br>2. 7. Sesioni informues për skemën e granteve per zhvillim rual – LOT 1 & 2",<br>2. 6. Pranimi i lëndëve-dokumentacioneve ,<br>2. 7. Monitorimi i projekteve,<br>2. 8. Miratimi i lëndeve në intanet. | | |
| 3. | Regjistrimi i fermerëve në regjistrin e fermës | 3. 1 Në vitin 2026 janë regjistruar 176 fermër te rinj,<br>3. 2. Pajisja e fermerëve me formular-Aneks,<br>3. 2. Pajisja e fermerëve me çertifikatë të fermerit-Nif. | Gjatë vitit | Stafi, Udheheqësi |
| 4 | Bashkëpunimi me MBPZHR- AZHB-në rreth programit Pagesave Direkte | 4. 1. Ështe bërë thirrja publike për pagesa direkte,<br>4. 2. Aplikimi, digjitalizimi i parcelave të fermerëve, dhe pranimi dokumentacionit ,<br>4. 3. Dorzimi i dokumentacionit-lëndeve në MBPZHR -AZHB (1848 lënd) **për pagesa direkte të sektorve të ndryshëm,**<br>4. 4. Plotësimi i dokomentacionit shtes të kërkuara nga AZHB. | Gjatë vitit | Stafi Udheheqësi-Drejtori |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. | Mbajtja e trajnimeve me fermerët në bashkpunim me MBPZHR si dhe OJQ-të. | 5. 1. Mbajtja e trajnimeve me fermerët (janar-dhjetor)<br>5. 2. Raportimi në MBPZHR për trajnimin e mbajtur nga OJQ-të,<br>5. 3. Raportimi mujor në Qendrën Informuese Këshilluese -MBPZHR-departamentin e shërbimeve këshillimore dhe teknike-DSHKT. | Gjatë vitit | Këshilltari komunal<br><br>Udheheqësi, Drejtori |
| 6. | Realizimi i mbjelljëve pranverore dhe vjeshtore | 6. 1. Monitorimi ne terrën për të verifikuar realizimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,<br>6. 2 Përgaditja e formulareve dhe raportimi per realizimin e të mbjellurave pranverore (2378 ha) dhe vjeshtore (3235)ne MBPZHR. | Prill-Nëntor | Stafi përkates<br><br>Udhëheqsi Drejtori |
| 7. | Fushata e korrje - shirjeve. | 7. 1 Në bashkëpunim me MBPZHR caktohët lartësia e cmimit për fushatën e korrje- shirjeve(130 ero/ha),<br>7. 2 Komisioni i caktuar nga zyra e Kryetarit përcjell fushatën e korrje shirjeve, përgadit raporte javore, pas përfundimit të fushatës së korrje-shirjeve përgadit raportin përfundimtar dhe e përcjelle në zyrën e Kryetarit dhe MBPZHR (rendimenti mesatar ka qene 5000 kg/Ha). | Qershor - Korrik | Komisioni përkatës |
| 8. | Vlerësimi i dëmeve nga fatkësit natyrore dhe fatkëqësit tjera | 8. 1. Komisioni i caktuar nga zyra e Kryetarit kryen këto punë:<br>8. 2. Pranon kërkesat për dëmet e shkaktuara nga fatkëqesit natyrore dhe fatkeqësit tjera,<br>8. 3. Dalja në teren, rreth vlerësimi dëmeve te shkaktuar,<br>8. 4. Komisioni përgadit raporte individuale i përmbledh në raport përfundimtar dhe se bashku me lëndet fizike i përcjell në nivel qëndror për kompenzim. | Gjatë vitit | Komisionet përkatse |
| 9. | Monitorimi i projekteve të DBZHR-së | 9. 1 Komisioni i caktuara nga zyra e Kryetarit monitoronë projektet sipas vendimit, | Gjatë vitit | Komisioni, Udhëheqësi, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 9. 2 Komisioni bënë raportimin rreth monitorimit te projekteve. | | Drejtori |
| 10 | Kërkesat për ndarjën e buxhetit dhe realizimi i shpenzimit sipas planifikimit gjatë vitit aktual si dhe percjellja e faturave për pagesë. | 10. 1. Hartimi i këkesave fillestare për buxhet për tri vitet në vijim,<br>10. 2. Kërkesat për zotim,<br>10. 3. Bashkangjitja e raporteve,<br>10. 4. Dorëzimi për pagesë. | Gjatë vitit | Udhëheqësi, Drejtori |

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik**

| Nr. | Objektivat | Aktivitetët | Afati | Bartës të aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Raporti i punës 2025 për Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik | Mbledhja e të dhënave<br>Pergaditja e raportit gjashtmujor<br>Përgaditja e të dhënave lidhur me Raportin<br>Përpunimi final i Raportit. | Janar | Udhëheqësi dhe Drejtori |
| 2 | Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029 | Vlerësimi dhe raportimi i planit të veprimit për vitin 2024 nga komisioni komunal,<br>Dërgimi i raportit tek komisioni i performancës,<br>Realizimi i planit të veprimit për vitin 2025. | Janar - Mars | DZHE dhe komisioni |
| 3 | Zgjatja e orarit të rregullt të punës sipas kërkesës si dhe hartimin e orarit të kujdestarive për barnatoret sipas rregullores në fuqi | Hartimi i vendimit,<br>Perpilimi i orarit për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, për ditët e punës të dielave dhe festave zyrtare,<br>Njoftimi të gjitha subjektet biznesore (barnatoret) për orarin e kujdestarive,<br>Shqyrtimi i kërkesa<br>v të bizneseve për zgjatjen e orarit të punës,<br>Hartimi i vendimeve per zgjatjen e orarit të punës sipas kërkesës,<br>Faturimi dhe inkasimi i pagesave. | Janar - Dhjetor | Zyrtari Përkatës, Udhëheqësi dhe Drejtori |
| 4. | Funksionalizimi i Zonës Ekonomike, vizitat e bizneseve dhe përkrahja me subvencioneve | Bashkpunimi me MNT lidhur me zhvillimet e punimeve në Zonën Ekonomike 2,<br>Vizita në bizneset e ndryshme,<br>Thirrja për aplikim sipas rregullores në fuqi për subvencionimin e Start-Up,<br>Formimi i komisionit,<br>Përzgjedhja e aplikuesëve ku janë subvencionuar 14 Star-Up , 9 Star-Up me pronarë femra dhe 5 me pronarë meshkuj,<br>Analiza sektoriale 2000- 2024 , si dhe krahasimi 2024-2025. | Janar - Dhjetor | Drejtori, Udhëheqësi, Komisioni. |
| 5 | Regjistrimi i bizneseve, | Aplikimi/ Procedimi i lëndëve në ARBK, | Janar - Dhjetor | Zyrtaret përkatës dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ndryshimeve, shuarjeve, duplikat. | Regjistrimi pas miratimit nga ARBK,<br>Regjistrimi i bizneseve fillestare - gjatë vitit 2025 janë regjistruar 258 biznese prej tyre SHPK -192 ndërsa 66 B,.<br>Nxjerrë Çertifikatën e biznesit me , nr. unifikues dhe informata shtesë – ripërtëririë-31 .<br>Kërkesë për informata shtesë – 86.<br>Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit -84,<br>Kërkesë për ndryshim të adresës – 9,<br>Kërkesë për shtim apo ndryshim te njësisë -12,<br>Kërkesë për certifikatë dublikat - 14,<br>Kërkesë për ndryshim të emrit tregtar -6,<br>Kërkesë për ndryshimin e pronarëve, aksionarëve -10.<br>Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar -3.<br>Kërkesë për ndryshim të emrit – 1.<br>Kërkesë për ndryshim të emalit ose adresës – 5,<br>Kërkesë për shuarje të biznesit - 38,<br>Kërkesë për shuarje të njësisë -3,<br>Kërkesë për ndryshim të bordit -2,<br>Kërkesë për ndryshim të numrit të punëtorëve -1,<br>Kërkesë për ndryshim e kapitalit - 1,<br>Vertitim që ka biznes - 1<br>Vertitim që s'ka biznes -74<br>Historiku i bizneseve -2,<br>Gjithsej shërbime të kryera në zyren e regjistrimit të biznesëve janë 641. | | Udhëheqësi |
| 6 | Ngarkesa e bizneseve me taksë vjetore sipas rregullores në fuqi dhe inkasimi | Azhurnimi i taksës komunale,<br>Regjistrimi i bizneseve fillestare në programin E-Taksa,<br>Faturimi i bizneseve aktive 2452,<br>Faturimi i bizneseve pasive 2136,<br>Verifikimi i bizneseve të shuara 1004,<br>Korrigjime të vendimeve/Proceset e inspeksionit -19. | Janar - Dhjetor | Zyrtaret përkatës dhe UdhëheqësiArhivimi i lendve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Deklarimet me zero gjatë vitit 2025 janë 165 kërkesa në vlerë prej 203, 190. 00 €,<br>Inkasimi i taksës komunal gjatë vitit 2025 janë 199 pagesa në vlerë prej 161, 000. 00 €,<br>Futja e pagesave në sistemin E-Taksa,<br>Barazimi me DF për pagesat mujore,<br>Arkivimi i lëndvë - 1291<br>Miratimi i lëndëve ne intranet - 2460. | | |
| 7 | Identifikimi i zonave turistike dhe bashkëpunimi me ministrit e linjës. | Promovimi i turizmi në aspektin ekonomik lokal.<br>Identifikimi i atraksioneve turistike –Kalaja e Vuqakut,<br>Promovimi i turizmit historik<br>Bashkëpunimi me Ministritë e linjës -tërheqja e turistëve në destinacionet turistike të komunës. | Vazhdueshme | Zyrtari përkatës , Udhëheqësi dhe Drejtori |
| 8 | Bashkëpunimet me ministrit e linjës, donatorët dhe ambasadat e huaja, lidhja e memorandumeve me arteret e ndryshëm , OJQ-të | Zhvillimi i dokumenteve dhe materialeve me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor,<br>Profili Ekonomik i Komunës i hartuar ku shihen potencialet rreth përparësive konkurruese qe ofron Komuna.<br>Nënshkrimi i marrveshjes mirëkuptimi në mes të Komunës së Drenasit dhe organizatës së bashkëpunimit me organiziatën Kosova-Women 4 Women,<br>Promovimi përmes OJQ-ve,<br>Promovimi përmes rrjeteve sociale. | Vazhdueshme | Drejtori, Udhëheqësi<br><br>dhe stafi DZHE |
| 9 | Realizimi i buxhetit për vitin 2024 | Kërkesat fillestare të buxhetit për vitet në vijim,<br>Kërkesat për zotim,<br>Bashkangjitja e raporteve,<br>Dorëzimi për pagës. | Janar-Dhjetor | Drejtori, Udhëheqsi dhe stafi DZHE |

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë periudhës **janar-dhjetor 2025**, detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në **Plan-programin** e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MFPT-së dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| -1- | Sektori i Buxhetit<br><br>Hartimi i Buxhetit në harmoni me qarkoret buxhetore dhe kërkesat e dalura nga degjimet buxhetore | Zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2026-2028, sipas kërkesave fillestare. | Planifikimi i buxhetit bazohet në Qarkoret Buxhetore të nxjerrura nga MFPT.<br>QRK nr. 01-2026. dt. 15. 05. 2025<br>QRK nr. 02/2026. dt. 21. 08. 2025 | ZKA, ZKF dhe Drejtoritë |
| | | Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 | Maj -Qershor 2025<br>Nr. 01/400/01-24428. dt. 30. 06. 2025 | ZKA, ZKF dhe Drejtoritë |
| | | Përgaditja e Draft-Vendimit të Buxhetit të Komunës për vitin 2026 dhe Parashikimi i Buxhetit 2027-2028 | Përgaditja e Draftë – Vendimit. 01/400-/01/41088 dt. 16. 09. 2025<br>Vendimi i Buxhetit të Komunës nr. 02/400/01-42589 dt. 25. 09. 2025 | ZKA, ZKF dhe Drejtoritë |
| | | Numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal: 1, 492 | Në bazë të kategorive ekonomike janë çertifikuar dhe aprovuar 3. 695 lëndë për vitin 2025 | Zyrtari çertifikues |
| | | Lëshimi i fletëpagesave sipas kërkesës së palëve. | 31. 962 fletëpagesa në arkë dhe<br>47 fletëpagesa për qira për 2025 | Arkatari ZHTV |
| | | Ruajtja e databazës për të dhënat e regjistruara | Gjatë gjithë vitit fiskal | ZHTV |
| | | Në këtë sektor, punët dhe detyrat do të kryhen si vijon: Arkëtimin e parave të imta për shërbime për të gjitha | 01. 01. -31. 12. 2025 | Arkatari Komunal |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | programet, dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës. | | |
| | Sektori i Thesarit<br><br>Ekzekutimi i buxhetit nëharmoni me kërkesat e njësive kërkuese sipas standardeve të Kontabilitetit | Regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara në databazë dhe në SIMFK. | Në baza ditore gjithë viti fiskal 2025 | ZTHV |
| | | Transferimi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të Thesarit MEF për çdo fund muaji. | Janar-Dhjetor 2025 | ZTHV |
| | | Barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë. | Çdo ditë punë në baza ditore gjatë vitit fiskal 2025 | ZTHV-Arkatari |
| | | Hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së. | Baza ditore dhe mujore | ZTHV |
| | | Zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të bletjes, dhe sipas modulit të aprovimit. | Sipas njesive kërkuese zotimet bëhen në baza ditore gjatë gjithë vitit fiskal 2025 | Zyrtari zotues |
| | | Kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm ( drejtoritë dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që janë të kompletuara. | Janë bërë shpenzimet si vijon: Investime kapitale 134, lëndë, Mallra & Sherbime:1. 590 lëndë, Komunali:1. 144 lëndë, subvencione 702 lëndë | Z. çertifikues |
| | | Certifikimi i avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendi. | Janë çertifikuer 5 avanse për udhëtime jashtë vendit | Z. çertifikues |
| | | Regjistrimi dhe dorëzimi i UOP-ve në arkiv | Është krijuar databaza për ruajten e të gjitha lëndëve të çertifikuera dhe lëndët në kopje fizike janë arhivuar | Z. çertifikues |
| | | Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesorë dhe programeve | Janë bërë raportet javore-mujore lidhur me shpenzimet e buxhetit sipas kategorive të shpenzimeve komunale | Zyrtari lartë për BF |
| | | Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2024. | 03-400/01-7634. dt. 25. 02. 25 | ZKF-z. lartë për BF |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| -II- | Sektori i Financave | Certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyrave komunale me modulin e blerjes dhe aprovimit. | Është bërë çertifikimi i lëndëve, sipas kërkesave të programeve në baza ditore-mujore dhe gjithë vitin fiskal | Z. çertifikues |
| | | Përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për 12 muajt e vitit. | Çdo ditë punë sipas njësive kërkuese | Z. çertifikues |
| | | Mbajtja evidencës analitike për të gjitha lëndët e certifikuara sipas shpenzimeve ( raporti analitik I SIMFK-së), | Çdo ditë punë sipas njësive kërkuese | Z. çertifikues |
| | | Raporti periodike -financiare për TM-1, TM-2, TM-3 dhe TM-4 për vitin 2025. | 01/400/-14418 dt. 18. 04. 25<br>01-400/27807- dt. 17. 07. 25<br>03-052/1-26871 dt. 11. 07. 25<br>01-, 400-46064 dt. 21. 10. 25<br>01-052/01-1823 dt. 14.01.2026 | ZAKF dhe DBF |
| | | Plani i punës për vitin 2026 | 24 Dhjetor 2025 | Drejtori DBF-së |
| | Zyra e Tatimit në Pronë | Evidentimi i rasteve të reja | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 348 |
| | | Verifikimet ne terren | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 1, 314 |
| | | Lëndë të miratuara | Gjatë vitit 2025 | 302 |
| | | Futja e nr personal | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | |
| | | Ndërrimi i banimit primar | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 120 |
| | | Regjistrim i tatimpaguesve, dhe jo tatimpaguesve | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 348 |
| | | Certifikata për tatimpaguesit | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 5101 |
| | | Shpronesime dhe ndrrime të pronarëve | 01. 01. 25-31. 12. 2025 | 120 |
| | | Vendime nga Sektori i Tatimit në Pronë | Gjatë vitit 2025 | 79 |
| | | Certifikata të tatimpaguesve dhe jo tatimpaguesit | Gjatë vitit 2025 | 373 |
| | | Fatura të shpërndara përmes postes | Janar-Prill 2025 | 6, 568 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Numri i ankesave të pranuara | Gjatë vitit 2025 | 79 |
| | | Pranimi i kërkesave për regjistrim të objekteve të reja. | Gjatë vitit 2025 | 348 |

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë**

| Objektivat | Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 |
|---|---|
| Objektivat kryesore Janar-Dhjetor 2025 | Në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë vitit 2025 ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me Planin e Punës. Angazhimi ka qenë i fokusuar në përmirësimin e shërbimeve publike, menaxhimin e projekteve kapitale, mbrojtjen e mjedisit dhe reagimin emergjent. |
| Përmbushja e obligimeve që dalin për Ditën Ndërkombëtare të Tokës, Mjedisit dhe pastrimit | DSHPE-ja ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe Ditën Botërore të Mjedisit, me fokus në mbrojtjen e biodiversitetit dhe rritjen e vetëdijes qytetare. Gjatë vitit është zbatuar aksioni gjithëpërfshirës "Bashkë për Pastërtinë në Komunën e Drenasit – Zemra e Kosovës", i cili ka përfshirë pastrimin e hapësirave publike, parqeve, liqenit të Vasilevës, brezave rrugorë dhe eliminimin e deponive ilegale, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e ambientit jetësor. |
| Menaxhmi në fushën e mbeturinave | Në fushën e menaxhimit të mbeturinave është vazhduar bashkëpunimi me KRM "Pastrimi" për grumbullimin e rregullt në të gjitha vendbanimet. Gjatë vitit është zgjeruar përfshirja e ekonomive familjare dhe bizneseve në sistem, ndërsa Inspektorati i Mjedisit ka mbështetur zbatimin në terren. Po ashtu, është përgatitur dhe dorëzuar Raporti Vjetor për Mbeturina në AMMK, përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e deponive ilegale. |
| Menaxhimi i punëve në realizimin e projekteve kapitale dhe atyre me Mallra dhe Shërbime | Gjatë vitit janë planifikuar, menaxhuar dhe realizuar projekte të shumta kapitale dhe shërbime komunale. Janë përfunduar punimet për rregullimin e rrethojave të varrezave në disa fshatra, rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara me mbi 700 m² sipërfaqe të riparuar, si dhe ndërtimi dhe zgjerimi i vendndalesave të autobusëve.<br>Është avancuar sistemi i kamerave të sigurisë me vendosjen e 11 kamerave të reja, si dhe është kryer mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik në të gjitha vendbanimet. Janë blerë dhe shpërndarë kontejnerë për mbeturina, është realizuar shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, si dhe është kryer mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe veror.<br>Gjithashtu, janë realizuar punime në kanalizime, rrugë me zhavor, hapësira të gjelbra, eliminimi i 16 deponive ilegale, mirëmbajtja e deponisë inerte, intervenime emergjente, rregullimi i trotuareve dhe parkingjeve, trajtimi i qenve endacakë dhe ofrimi i shërbimeve të |

| | |
|---|---|
| | varrimit për qytetarët.<br>Në fushën e efiçiencës së energjisë është krijuar databaza për objektet publike, janë zbatuar masa efiçiente dhe janë siguruar grante për panele solare në disa objekte publike dhe shkolla. |
| Realizimi i Planit të Transportit Publik | Plani Lokal i Transportit Publik 2021–2026 është zbatuar me sukses. Për vitin 2025 janë realizuar të gjitha 11 aktivitetet e planifikuara. Nga 42 vendbanime, 40 janë të përfshira në transportin urbano-periferik, me gjithsej 226 vendndalesa autobusësh, nga të cilat 215 janë shenjëzuar. |
| Ndarja e subvencioneve | Janë realizuar subvencione për kompensimin e dëmeve nga zjarret në pesë raste, me vlerë totale 1, 764 euro. |
| Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave | Gjatë vitit janë trajtuar 571 kërkesa dhe lëndë të qytetarëve, që kanë përfshirë mirëmbajtje infrastrukturore, ndriçim publik, shenjëzim rrugor dhe pastrim deponish. Janë përgatitur dhe përcjellë faturat mujore për shërbimet komunale. Megjithatë, për shkak të procedurave përmbarimore, disa obligime kanë mbetur të papaguara, duke paraqitur rrezik për furnizimin me energji elektrike. |
| Rritja e profesionalizmit në Njësin profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpetimit | Në bashkëpunim me Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit janë trajtuar me qindra raste emergjente, përfshirë zjarre, aksidente dhe vërshime. |
| Takimet zyrtare | Po ashtu janë zhvilluar takime të rregullta me institucione qendrore, organizata ndërkombëtare, agjenci, biznese dhe qytetarë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e shërbimeve publike në Komunën e Drenasit. |

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Raporti i punës Janar – Dhjetor 2025

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| | | 4. Raporti vjetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 2025. | Janar-Shkurt 2026 - i përfunduar | DSHMS |
| -I- | Rritja e Mirëqenjes tek | 5. Ofrimi i ndihmës financiare për përsonat me diagnozë të rëndë, shërim rehabilitim mjekësorë për përsonat me asistencë sociale 158 kërkesa prej tyre 142 të realizuara,<br>6. subvencionimi i lehonave 4487 kërkesa prej tyre te aprovuara 480,<br>7. Subvencionimi i OJQ Handikos,<br>8. Subvencionimi me miell per familjet në nevojë, | Shqyrtimi i kërkesave, çdo muaj , dy muaj ose çdo tre muaj, varësisht nga buxheti i alokuar | Komisionet e caktuar me vendim DSHMS |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | qytetarët e Komunës përmes mundësive të për banimit, dhe subvencionimit | 9. Shqyrtimi i kërkesave QKMF-së për kompensim, përgjigjet shkresave, ankesave, Procesimi i lëndëve në intranet 1586 lëndë, | 30 ditë, | DSHMS |
| | | 10. Raporti gjashtëmujor i DSHMS, QKMFdhe QPS | Shtator | DSHMS |
| | | 11. Lëshimi i vertetimeve për viktima civile, shtëpi të djegura. të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, të plagosurit etj. | Sipas kërkesave | DSHMS |
| | | 12. Përfundimi i projektit për rinovimin e njësive banesore sociale permes FKEE-së, | Nëntor | DSHMS |
| | | 13. Vlerësimi i përformancës së zyrtarëve | janar | Udhëheqësit e drejtpërdrejtë |
| | | 14. Shpallja publike për zgjidhjen e çshtjës së banimit per banesat sociale social dhe verifikimi i rasteve në terren | Janar -shkurt | Komisioni i caktuar |
| | | 15. Shpallje publike për banimin adekuat lidhur me nenprojektet; rinovimi/rindertimi i shtëpive individuale për familjet e cenueshme dhe ndertimi i njësive të reja banesore përmes MMPHI | Korrik Gusht | DSHMS Njësiti për Impelementimin e Projektit |
| | | 16. Raportimi për indikatorët e Përformancës Komunale - Treguesit e Fushës tek Përfaqësimi Gjinor (10 indikatorë), si dhe fusha Barazia në Punësim, Shërbimet Sociale dhe Familjare me gjithësej 4 indikatorë | Pas hapjes së afatit të periudhës raportuese në SIMPK, janë futur të gjitha të dhënat që kanë qenë nga të dy fushat nga zyrtarët e caktuara ne DSHMS | Zyrtaret e caktuar sipas vendimit te zyrës se kryetarit |
| II | Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale | 17. Projektte e realizuara:<br>Furnizim me barera dhe material shpenzues mjekesore<br>Furnizim me oksigjen<br>Furnizim me material stomatologjik<br>Furnizim me artikuj per KPSH (veglari),<br>Vlerësimi i Rriskut<br>Polisa e sigurimit per 5 vetura | Sipas Planit të Prokurimit dhe sipas legjislacionit të Prokurimit Publik | QKMF, DSHMS, Zyra e Prokurimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Paisje stomatologjike<br>-Mirëmbajtja e aparaturave Laboratorike<br>Material Stomatologjik<br>Mirembajtja higjienike e objekteve shendetesore ne komunen e Drenasit<br>Statika Revidimi i QKMF Drenas<br>Mirembajtja dhe Servisimi i Aparaturave laboratorike (Ritenderim )<br>Mirëmbajtja dhe Servisimi i kalldajes se ngrohjes qendrore në QKMF<br>Ventilimi dhe Pastrimi i ajrit ne kabinetin e radiologjise në QMF Komoran<br>Mirembajtja e Paisjeve Mjekësore - Aparaturave<br>Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve<br>Mirembajtja dhe servisimi i gjeneratoreve<br>Mirembajtja e sistemit të ngrohjes qendrore -kalldajave<br>Furnizim me inventar të QKMF<br>Furnizim me UPS për pasije laboratorike<br>Mirembajtja e oborrit te QKMF<br>Furnzim me Paisje mjekësore | | |
| | | Numri i vizitave në KPSH 189649, dhe numri i shërbimeve 673599<br>Numri i lindjeve 3<br>Numri i fëmijëve të vaksinuar 7217, ndërsa numri i dozave 13979 | Dhjetor | QKMF DSHMS |
| | | Hapja e njësisë së RTG në QMF Komoran, Rritja e kapaciteteve humane dhe infrastrukturore, Hapja e Dhomave të edukimit dhe promovimit shëndetësorë, Drenas dhe Komoran, Trajnimi i Mjekut Familjar për USG, Vizitat paliative, Vizitat për nëna dhe fëmijë, Vizitat në , Trajnimi i 5 infermierve per vozitje emergjente, shtepi për gratë shtatëzana dhe femijët deri 3 vjeç, vleresimi i mbrojtjes kunder zjarrit , Trajnimi i stafit për mbrojtje në punë, Trajnimi i 2 personave për mbrojtje kunder zjarrit<br>Trajnimi i 2 personave ekspert të sigurisë ne punë | Sipas projekteve dhe standardeve të KPSH-së | DSHMS |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Ankeskesa të shqyrtuara 13<br>Incidente te raportuara 14 | | |
| | | Mbikqyrja e projeketeve dhe implementimi i tyre:<br>Vendimet per menaxher dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejt<br>Përcjellja e punimeve në teren, pranime teknike etj. | Punët dhe përgjegjësitë sipas vendimeve janë përcjellë përmes menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejt | DSHMS |
| | | Procedimi i kerkesave të reja për ndihmë sociale dhe verifikimi i tyre. | Futja në sistem e kërkesave të reja dhe verifikimi i tyre | QPS |
| III. | QPS<br>Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare<br><br>Ulja e numrit të shfrytezuesve të ndihmës sociale sipas muajve për vitin 2024 | Perfundimi zbatimit të SAS-PILOTIMI (aplikimi është kryer përmes E-kosovës për periudhën një vjeçare) Pilotimi gjithësej 232 familje përmes e Kosovës. | .<br>Vizitat në terren , këshilla dhe ndihmë në aplikim<br>Futja në sistemin e kërkesave të reja | QPS<br>Departamenti i MS |
| | | Janar 667<br>Shkurt 659<br>Mars 645<br>Prill 625<br>Maj 623<br>Qershor 604<br>Korrik 595<br>Gusht 578<br>Shtator 571<br>Tetor 566<br>Nentor 564<br>Dhjetor 570 | Verifikimi në terren | QPS<br>Departamenti i MS |

Raporti statistikor përfundimtar për vitin 2025 i Shërbimeve Sociale:

| | Kategoria | Të bartura nga viti 2024 | Lëvizja e lëndëve (gjatë vitit-2025) | | Lëndët që barten per vitin 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Të reja | Të mbyllura | |
| 1. | I. a-Fëmijët e braktisur | 7 | 2 | 2 | 7 |
| | I. b-Fëmijët jetim (pa dy prindër ) | 4 | 1 | 1 | 4 |
| | I. c-Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrave prindërore | 6 | 1 | 2 | 5 |
| | I. d-Fëmijët të strehuar ne familje strehuese apo SOS fshatin | 1 | / | / | 1 |
| 2. | Familje strehuese | 1 | / | / | 1 |
| 3. | Kërkesa për adoptim vendor | 1 | 1 | / | 1 |
| 4. | Kërkesa për adoptim ndërkombëtar | / | / | / | / |
| 5. | Fëmijë të keqtrajtuar | 30 | 12 | 5 | 37 |
| 6. | Fëmijët me sjellje asociale | 28 | 10 | 2 | 36 |
| 7. | Të miturit në konflikt me ligjin | 25 | 15 | 2 | 38 |

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Raporti vjetor i punës për vitin 2025

Sektori i Kadastrit

| Raport vjetor i punës për vitin 2025. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Sektori i Kadastrit | Total | Lendet e aprovuara | Lendet e refuzuara | Lendet e procesuara |
| Bartja e posedimit – Ndarje fizike | 26 | 25 | 0 | 1 |
| Bartja e posedimit – Blerje | 373 | 353 | 5 | 15 |
| Bartja e posedimit – Dhurim | 520 | 505 | 8 | 7 |
| Bartja e posedimit – Këmbim | 9 | 9 | 0 | 0 |
| Bartja e posedimit – Trashëgimi | 220 | 212 | 4 | 4 |
| Bartja e posedimit – Ndërtim kompensim | 11 | 11 | 0 | 0 |
| Bartja e pronësisë – Ndarje Fizike | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Bartja e posedimit – Ndërtim kompensim | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Bartja e pronësisë – Këmbim | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Bartja e pronësisë – Trashëgimi | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Bartja e qiramarrjes te qiramarrësi i ri | 2 | 2 | 0 | 0 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme | 75 | 70 | 5 | 0 |
| Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme pa njësi | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit | 53 | 50 | 3 | 0 |
| Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK-së | 4 | 4 | 0 | 0 |
| Fshirja e njësisë kadastrale | 11 | 10 | 0 | 1 |
| Fshirja e qiramarrjes sipas marrëveshjes | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Fshirja e vërejtjes me kërkesë të palës | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Krijimi i bashkëpronësisë | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Krijimi i kopjes zyrtare të planit | 1423 | 0 | 5 | 1418 |
| Modifikimi atributeve të ndërtesës | 2 | 0 | 2 | 0 |
| Modifikimi atributeve të parcelës | 159 | 146 | 13 | 0 |
| Modifikimi atributeve të pjesës së ndërtesës | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Modifikimi i drejtës së shfrytëzimit | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Modifikimi i hipotekës | 6 | 3 | 1 | 2 |
| Modifikimi i ngarkesës tatimore | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Modifikimi i të dhënave të përsonit pa njësi kadastrale | 60 | 53 | 6 | 1 |
| Modifikimi i të drejtave | 88 | 87 | 1 | 0 |
| Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re | 9 | 9 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i hipotekës | 66 | 63 | 2 | 1 |
| Regjistrimi i ngarkesës tatimore | 15 | 15 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i posedimit të pronës shoqërore sipas detyrës zyrtare | 4 | 4 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i qiramarrjes | 4 | 4 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i servitutit | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i vërjtjes sipas kërkesave tjera | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Shërbimi i të dhënave – nxjerrja e Certifikatës | 2289 | 0 | 0 | 2289 |
| Shërbimi i të dhënave – vërtetim që nuk posedon pronë | 940 | 0 | 0 | 940 |
| Përgjigje zyrtare | 23 | 0 | 2 | 0 |
| | 6413 | 1655 | 58 | 4679 |
| | | | | |
| **Sektori i Gjeodezisë** | Total | Lëndët e aprovuara | Lëndët e refuzuara | Lëndët e procesuara |
| Bashkimi | 101 | 90 | 11 | 0 |
| Fshirja e njësisë kadastrale | 11 | 10 | 0 | 1 |
| Krijimi i kopjes zyrtare të planit | 1423 | 0 | 5 | 1418 |
| Krijimi i bashkëpronësisë | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Modifikimi atributeve të ndërtesës | 2 | 0 | 2 | 0 |
| Modifikimi atributeve të parcelës | 159 | 146 | 13 | 0 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Modifikimi i atributeve të pjesës së ndërtesës | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Ndarje | 247 | 223 | 19 | 5 |
| Ndarje e ndërtesës | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re | 9 | 9 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i hapësirave të përbashkëta | 4 | 4 | 0 | 0 |
| Regjistrimi i ndërtesës | 98 | 88 | 7 | 3 |
| Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës | 11 | 11 | 0 | 0 |
| Përgjigje zyrtare | 26 | 0 | 6 | 0 |
| | 2095 | 585 | 63 | 1427 |
| **Sektori i Pronës** | Total | Lendet e aprovuara | Lendet e refuzuara | Lendet e procesuara |
| Kërkesa për caktim të pikave gjeodezike | 38 | 38 | 0 | 0 |
| Dalje në teren | 29 | 29 | 0 | 0 |
| Procedura për dhuim të pronave | 12 | 9 | 1 | 2 |
| Kërkesë për kompenzim | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Kërkesa për këmbim | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Kërkesë për qasje në dokumente publike | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Lëndët e vjetra të skanuara | 4500 | 0 | 0 | 3200 |
| Përgjigje zyrtare | 10 | 10 | 0 | 0 |
| | 4593 | 90 | 1 | 3202 |
| Raporti total i të hyrave në Drejtori | 66,915.50 | | | |

Kryetari i Komunës

**Ramiz Lladrovci**